2. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për hidrokarburet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të neneve 8, pika 5, dhe 26, pika 7 të këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për financat brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr udhëzim për zbatimin e tij.



Neni 31
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.12.2020.

DEKRET
Nr. 11914, datë 12.1.2021

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Daniela Rusland Xhindoli
2. Vojsava Sami Sfyris (Kola)
3. Aurel Zeni Qinami
4. Elida Kristaq Margariti (Shandro)
5. Anton Ukshin Nika
6. Olimpion Jani Vodo
7. Esmiralda Muharrem Kurti (Tafaj)
8. Espera Samel Kurti
9. Elda Llambi Laux (Dylgjeri)
10. Aferdita Spiro Iannone (Berdufi)
11. Kristian Edmond Dilo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 6, datë 13.1.2021

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2021, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.


2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



SHTOJCA NR. 1 PEMA E PROGRAMIT TË ASHK-së PËR VITIN 2021



SHTOJCA NR. 2 BUXHETI I AGJENCISË SHËTETËRORE TË KADASTRËS 2021

PËRSHKRIMI	000/lek	
	Buxheti Janar- Dhjetor 2021	
	Të Ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga Shërbimet +Parcela ndërtimore	4,097,530	
Shpenzime personeli		1,793,562
Shpenzime korente		600,000
Shpenzime kapitale		1,109,268
Fonde të parashikuara për ti transferuar ATP-së gjatë vitit		490,000
Fondi rezervë		104,700
Total	4,097,530	4,097,530
Teprica (1)-(2)		0



SHTOJCA NR. 3
BUXHETI I AGJENCISË SHËTETËRORE TË KADASTRËS 2021

		000/lek
Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI JANAR - DHJETOR 2021
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	4,097,530
1	Të ardhura nga shërbimet	1,640,000
2	Të ardhura nga transferimi I parcelës ndërtimore	700,000
3	Të ardhura të tjera	90,000
4	Fonde që trashëgohen nga viti 2020	1,667,530
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	4,097,530
1	Shpenzime personeli	1,793,562
	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të miratuar	948,609
	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit në organikë	157,236
	Paga për punonjësit me kontratë(690)	548,660
	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit me kontratë	91,626
	Fondi i vecantë i pagave	47,430
2	Shpenzime operative	600,000
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	450,000
	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	150,000
3	Shpenzime Kapitale	1,109,268
	Investime kapitale të patrupëzuara	396,588
	Drejtoria e Projektit të përmirësimit përditësimit (300)	303,000
	Shpenzime për investime tjera të patrupëzuara	93,588
	Investime kapitale të trupëzuara(Rikonstruksion +Infrastruktura IT)	712,680
	Rikonstruksione(Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+ Vlore)	600,000
	Infrastruktura e sistemeve te IT+ blerje paisje dhe orendi)	112,680
4	Trasferim në fondin special të ATP-së	490,000
5	Fondi Rezervë	104,700
	Fondi Rezervë	104,700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	0

**VENDIM****Nr. 7, datë 13.1.2021**

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK E FISKAL,
PËR PERIUDHËN 2022–2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, për periudhën 2022–2024, si dhe lidhjen nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë” dhe lidhjet nr. 2/1 e nr. 2/2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe**

**KUADRI MAKROEKONOMIK
DHE FISKAL, 2022–2024
JANAR, 2021**

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime

Hyrje

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

2. Politikat fiskale

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike
Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Lidhja nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë”

Lidhja nr. 2/1 “Treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)”

Lidhja nr. 2/2 “Treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)”

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	<i>World Economic Outlook</i>

**KUADRI MAKROEKONOMIK DHE
FISKAL, 2022–2024
MINISTRIA E FINANCave
DHE EKONOMISË**

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF), për periudhën 2022–2024 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë, në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), 2022–2024, në nivel ministrie.

KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve për shpenzimet.

KMF-ja përmban dy komponentë kryesorë: i. parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tri vitet e ardhshme; dhe ii. parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskalë, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë, për vitet 2022–



2024, dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë, sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht lidhja nr. 1, lidhja nr. 2/1 dhe lidhja nr. 2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit ka treguar një trend pozitiv zhvillimi, që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Megjithatë ekonomia shqiptare përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij. Në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli dëme në njerëz dhe në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u përhap edhe në Shqipëri, masat e ndërmarra ndaj së cilës, impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend. Viti 2019 shënoi rritje ekonomike prej 2.2 përqindësh krahasuar me rritjen prej 4.1 përqindësh të një viti më parë, si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit, por edhe si pasojë e goditjes nga tërmeti.



Përgjatë vitit 2020 ekonomia globale u përball me vazhdimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet publike për frenimin e përhapjes. Në Shqipëri, qeveria vendosi kufizime të lëvizjes së lirë që prej muajit mars, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë në vend. Shqipëria është, veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë, për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia. Sipas vlerësimeve më të

fundit nga INSTAT, PBB reale u tkurr me 2.34 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë, duke u pasuar nga një rënie më e thellë prej -10.20 përqindësh në tremujorin e dytë dhe nga statistikatat e fundit të publikuara nga INSTAT-i, në tremujorin e tretë, rënia është zbutur në shifrën -3.47 për qind krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2019. Ndërsa në terma nëntëmujorë për vitin 2020, ekonomia ka pësuar rënie me 5.52 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të 2019.

Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja përgjatë vitit 2019 u gjenerua nga konsumi final, si dhe nga kërkesa e brendshme. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2020, vlerësohet se të gjithë komponentët e kërkesës agregate kanë pësuar rënie të fortë. Pasojat e masave shtrënguese për frenimin e përhapjes së pandemisë, kanë sjellë tkurje të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, konsumit familjar dhe investimeve totale në ekonomi. Ndërkohë, sa u takon investimeve në ekonomi, rënie kanë pasur vetëm ato private, ndërsa investimet publike (duke përfshirë këtu edhe investimet për rindërtimin pas tërmetit) kanë pasur rritje të konsiderueshme. Këto kanë shërbyer edhe si një prej “amortizuesve” të goditjes së fortë negative gjatë vitit 2020.

Konsumi final për nëntëmujorin 2020 ka shënuar një rënie prej 3.4 përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019, me një kontribut negativ në rritjen e PBB-së prej rreth 4.3 pikë përqindjeje. Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) ka shënuar një rënie prej 7.4 përqindësh, me kontribut negativ në rritjen ekonomike prej rreth 2.4 pikë përqindjeje. Kështu, kërkesa e brendshme agregate ka pasur një tkurje për nëntëmujorin prej 4.2 përqindësh, e një kontribut negativ në rritjen e PBB-së prej rreth 6.7 pikë përqindjeje. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, sipas vlerësimeve të INSTAT, gjatë nëntëmujorit të vitit 2020 janë tkurrur në mënyrë drastike me rreth 29.6 për qind. Por ndërkohë, duke qenë se edhe tkurja e importeve të mallrave dhe shërbimeve ka qenë po ashtu tepër e fortë, si dhe në reflektim të peshës së lartë që importet kanë në ekonominë tonë, ka rezultuar në një rritje të kërkesës së huaj neto (ngushtim të deficitit midis eksporteve dhe importeve) krahasuar me një vit më parë me rreth 6.6 për qind, e rrjedhimisht duke dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së prej rreth 1.2 pikë përqindjeje.



Nga pikëpamja e ofertës agregate, dy sektorët të cilët kanë pësuar rritje përgjatë periudhës nëntëmujore të viti 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Bujqësia” me rritje prej 1.8 përqindësh dhe kontribut pozitiv prej 0.3 pikë përqindjeje, si dhe “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me rritje prej 5.9 përqindësh dhe kontribut pozitiv prej 0.4 pikë përqindjeje. Sektorët e tjerë kanë pësuar rënie në rendin vijues, ku: “Tregtia me shumicë dhe pakicë” është ulur me 15 për qind dhe kontribut negativ prej 2.4 pikë përqindjeje; “Aktivitete shkencore dhe profesionale” me rënie prej 14.4 përqindësh dhe kontribut prej -0.9; “Arte, argëtim dhe çlodhje” me rënie prej 10.8 përqindësh dhe kontribut prej -0.2; “Industria” me rënie prej 5.4 përqindësh dhe kontribut prej -0.7 pikë përqindjeje etj.

Dinamika në tregun e punës ka reflektuar përgjithësisht atë të aktivitetit ekonomik. Ndërkohë që viti 2019 rezultoi me një reduktim të mëtejshëm të shkallës së papunësisë me një nivel mesatar për gjithë vitin prej 12 përqindësh (për grup-moshën 15–64 vjeç), nëntëmujori i 2020 regjistroi një përqendrim të konsiderueshëm të këtij treguesi në gjysmën e parë të vitit dhe më pas një rikuperim në tremujorin e tretë. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, norma e papunësisë (për grup-moshën 15–64 vjeç) regjistroi nivelin prej 11.9 përqindësh në tremujorin e parë, 12.5 përqindësh në të dytin dhe ra sërish në 12.1 përqindësh në T3-2020. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2020 ishte 12.2 përqindësh, duke qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel prej 12.1 përqindësh të nëntëmujorit të 2019. Ndërkohë, për grup-moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 regjistroi nivelin prej 11.6 përqindësh, me një rritje prej vetëm 0.2 pikë përqindjeje nga tremujori i tretë i 2019.


Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të BSH-së, bilanci i pagesave (BP) për vitin 2019, shënoi rënie kundrejt një viti më parë, duke arritur vlerën -77.6 milionë euro, nga 371.4 milionë euro në 2018. Ndërsa për nëntëmujorin e parë të vitit 2020, bilanci i pagesave regjistroi balancë pozitive prej 797.3 milionë eurosh, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku shënonte balance negative prej -4.8 milionë eurosh. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 805.5 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 62 milionë euro

(ose 8.4%). Brenda llogarisë korente, balanca e llogarisë së shërbimeve të lidhura përgjithësisht me Turizmin u ngushtua në vlerën +731.7 milionë euro ose 55.3% më pak krahasuar me +1.636.7 milionë euro në të njëjtën periudhë të një vitit më parë. Ndërsa remitancat për periudhën nëntëmujore të vitit 2020 shënuan rënie në vlerën +470.4 milionë euro, krahasuar me +520.0 milionë euro krahasuar me periudhën respektive të një viti më parë. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2020, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +1.528 milionë euro krahasuar me +800 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky zgjerim i balancës së llogarisë financiare ishte rrjedhojë e rritjes së fortë të flukseve hyrëse financiare, kryesisht huamarrje shtetërore (Eurobondi, kreditë në formën e mbështetjeve buxhetore nga institucionet financiare ndërkombëtare etj.), ndërkohë që investimet e huaja direkte shënuan vlerën +739.4 milionë euro ose 11.1% më pak krahasuar me +831.6 milionë euro në nëntëmujorin e parë 2019.

Inflacioni mesatar përgjatë vitit 2019 ishte 1.4 për qind, nga 2 për qind që ishte një vit më parë. Ndërsa inflacioni mesatar për periudhën janar–nëntor të vitit 2020 është 1.7 për qind. Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore ka qëndruar përgjithësisht mjaft stabil. Kursi mesatar lekë/euro për janar–nëntor 2020 ishte 123.8 nga 123 që ishte mesatarisht gjatë vitit 2019. Ndërsa kursi mesatar lekë/USD për janar–nëntor 2020 ishte 109.3 nga 109.9, që ishte mesatarisht gjatë 2019.

2. Politikat fiskale

Pas një stimuli të lartë, të domosdoshëm dhe njëkohësisht të paevitueshëm gjatë vitit 2020 me qëllim amortizimin e goditjeve negative (tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2022–2024 do të riorientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që siguron një nivel investimesh publike prej mesatarisht rreth 4.8 përqindësh të PBB-së në vit (vetëm nga qeveria qendrore). Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2022–2024 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit (shih kuadratin në faqen 8).



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 2.9 përqindësh të PBB-së për 2022-shin, nga 6.5 për qind i programuar për vitin 2021; nivel prej 2.3 përqindësh të PBB në 2023-shin; dhe 2 për qind në vitin 2024. Njëkohësisht, si rrjedhojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme fillimisht nga tërmeti dhe më pas shumë më fort nga pandemia COVID-19, balanca primare pritet të shënojë vlera lehtësisht negative edhe për vitin 2022, në rreth 0.1 për qind, ndonëse me përmirësim të fortë nga niveli negativ prej 3.9 përqindësh, që pritet për 2021, ndërkohë që targetohet në vijimësi rikthimi në vlera pozitive që prej vitit 2023 me 0.6 për qind dhe 1.1 për qind në vitin 2024.

Lidhur me balancën primare, i cili është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, së fundmi (korrik 2020) u shtua edhe një rregull i ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të *aquis* të BE, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarëvajtjes së ekonomisë së vendit. Më konkretisht, duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të këtij kuadri aktual, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objekti (rregulli fiskal) të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik neto rreth nivelit prej 68 përqindësh të PBB-së deri në vitin 2025 nga rreth 78.6 për qind që pritet të rezultojë në 2021.



PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr.9936, datë 26.6.2008, të ndryshuar, KMF 2022-2024 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2022-2024 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.**

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva ekonomike botërore" (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2022-2024 bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve më të fundit të FMN. Në këtë rast, sipas shënimit të bërë në WEO më të fundit të publikuar në muajin Tetor 2020, ku thuhet se "Projeksionet WEO u përgatitën përpara misionit të parë të Monitorimit Pas Programit që përfundoi në 28 shtator dhe kështu nuk pasqyrojnë përditësimet e bëra gjatë misionit", për referencë janë marrë shifrat e PBB nominale të misionit më të fundit të FMN (misioni i Monitorimit Pas Programit, i kryer në Shtator 2020).

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN		(në miliardë Lekë)						
		2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
				Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
MFE		1,635.7	1,679.3	1,572.3	1,682.6	1,803.0	1,928.8	2,050.8
FMN		1,635.7	1,678.4	1,572.5	1,682.8	1,803.8	1,929.9	2,052.3
Diferenca MFE - FMN	(Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.9	-0.2	-0.2	-0.8	-1.1	-1.5

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 përqind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2022-2024 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar "Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit, etj." një kontingjencë prej mbi 0.7 përqind e shpenzimeve totale.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 përqind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit nr.9936, datë 26.6.2008, të ndryshuar, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2022-2024 **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – "rregulli i artë") të LOB, deficit i targetuar në Kuadrin 2022-2024 është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara. Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 2.4 përqind të PBB në çdo vit të programuar.

6. Në çdo vit buxhetor që prej vitit 2023 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (suficit primar).

Në përputhje me këtë dispozitë, Kuadri 2022-2024 targeton një balancë primare pozitive në vitin 2023 me 0.6 përqind dhe 1.1 përqind në vitin 2024.

1. Linku për raportin "WEO" – <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/09/30/world-economic-outlook-october-2020>



3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si: INSTAT-i, BSH-ja, MFE-i, FMN-ja, BB-ja, Eurostatit etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tri viteve në vijim, nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtijshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit mundësisht që prej vitit 2022, por domosdoshmërisht prej vitit buxhetor 2023 dhe në vijim. Që prej korrikut 2020 ky objektiv tashmë është sanksionuar edhe në LOB nëpërmjet përfshirjes së një rregulli të ri fiskal.

- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit

dhe mundësisht mbi nivelin 4.5 për qind të PBB-së mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 për qind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare.

- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysHEME të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recensionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -4.4 për qind, ekonomia pritët të rrekuperohet në vitin 2021 dhe të vijoje trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 5.5 për qind në vitin 2021 dhe parashikohet mesatarisht rreth 4.4 për qind në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2022–2024. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 4.8, 4.5 dhe 3.9 për qind, respektivisht për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritët të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport–import) pritët të ketë një efekt pothuajse neutral, marxhinalisht në kahun pozitiv. Konsumi privat pritët të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritët të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtijshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrjeje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ nga goditja e pandemisë.



Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies priten të jenë një faktor i rëndësishëm incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.


Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2022–2024) parashikohet të rritet në terma realë, me mesatarisht rreth 3 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.7 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë, mesatarisht në rreth 6.4 për qind në vitet 2022–2024, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.5 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë efekt pothuajse neutral në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave, të cilat zakonisht kanë pasur

performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të rikthejnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, për periudhën 2022–2024, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 8.8 për qind në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.5 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa, importet e mallrave dhe të shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 5.5 për qind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së, me rreth 2.2 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto, kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv, pothuajse neutral, në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.2 pikë përqindjeje në vit.

Grafik: Rritja reale (majtas, në përqindje) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.), sipas komponentëve të kërkesës agregate



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në mbi 4.5 për qind të PBB-së, në vitet 2022–2024 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese parashikuar në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ulëta inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimul në sektorin privat,



fondamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Grafik: Rritja reale (majtas, në përqindje) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.), sipas komponentëve të ofertës agregate




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 2.5 për qind në vit në terma realë, përgjatë periudhës 2022–2024, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.5 pikë përqindjeje; Industria, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.2 përqindësh dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.6 pikë përqindjeje; Ndërtimi me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.5 përqindësh dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.3 pikë përqindjeje; Shërbimet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.1 përqindësh dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.5 pikë përqindjeje.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 1.2 përqindësh në vit gjatë viteve 2022–2024. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Me gjithë zgjerimin e pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të vijojë një përmirësim gradual gjatë kësaj periudhe.

Grafik: Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në përqindje) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në përqindje)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për forcimin e kërkesës agregate dhe inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të përçojnë një efekt inflacionist, disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare në afatin e mesëm.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur VKM-së.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave dhe ndryshimeve fiskale të ndërmarra dhe veçanërisht ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, përfshirë këtu edhe efektet e pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tri vitet në vijim (2022–2024) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 7.1 për qind në çdo vit. Më specifikisht 6.9 për qind për vitin 2022, 7.6 për qind për 2023 dhe 6.9 për qind për 2024. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 8.1 përqindësh.


Grafik: Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tri vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2022–2024 pritet të jenë mesatarisht në rreth 602.1 miliard lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 31.2 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 4.8 për qind të PBB-së në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik: Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqindje të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëlidhur vendimin e Këshillit të Ministrave, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.

Lidhja nr. 1 – Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Inflacioni (mesatar)	%	1.3	2.0	2.0	1.4	1.7	2.4	2.8	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	-0.6	1.5	1.4	0.5	-2.1	1.5	2.2	2.4	2.4
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	124.1	119.1	108.0	109.9	108.9	108.9	108.9	108.9	108.9
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	137.4	134.2	127.6	123.0	123.8	123.8	123.8	123.8	123.8
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	42.7	41.4	41.3	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	55.6	55.6	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7
Rritja reale e PBB	%	3.3	3.8	4.1	2.2	-4.4	5.5	4.8	4.5	3.9
PBB	Lek miliardë	1,472.5	1,550.6	1,635.7	1,679.3	1,572.3	1,682.6	1,803.0	1,928.8	2,050.8
PBB	USD miliardë	11.9	13.0	15.1	15.3	14.4	15.4	16.6	17.7	18.8
PBB	Euro miliard	10.7	11.6	12.8	13.7	12.7	13.6	14.6	15.6	16.6
PBB për banor	Lek mijë	512.0	539.6	570.7	588.4	552.0	592.0	635.9	682.2	727.6
PBB për banor	USD	4,124.0	4,531.0	5,284.4	5,356.0	5,068.1	5,435.8	5,838.9	6,263.9	6,680.8
PBB për banor	Euro	3,727.1	4,022.7	4,472.6	4,782.8	4,459.0	4,782.5	5,137.2	5,511.1	5,877.9
PBB për banor	USD-PPP	12,002.9	13,037.0	13,834.0	14,503.5	13,606.3	14,593.4	15,675.6	16,816.6	17,935.9
PBB për banor	Euro-PPP	9,206.8	9,702.9	10,240.4	10,569.5	9,915.7	10,635.0	11,423.7	12,255.2	13,070.9
Norma e papunësisë	%	15.6	14.1	13.0	12.9	12.0	11.1	10.3	9.4	8.9
Të ardhurat totale	% të PBB	27.6	27.8	27.5	27.4	27.0	28.8	28.7	28.9	29.0
Shpenzimet totale	% të PBB	29.5	29.8	29.1	29.3	33.7	35.2	31.6	31.1	31.1
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-6.7	-6.5	-2.9	-2.3	-2.0
Bilanci primar fiskal	% të PBB	0.7	0.1	0.6	0.2	-4.5	-3.9	-0.1	0.6	1.1
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	2.6	3.0	3.2	2.6	-0.6	0.7	1.9	2.5	2.8
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	71.7	68.8	64.7	65.3	78.6	78.2	75.7	72.8	70.5
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	72.4	70.2	67.7	66.3	79.9	78.6	77.7	75.6	73.8
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	68.7	66.9	64.9	63.7	75.1	75.4	74.9	73.1	71.6
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.7	3.3	2.8	2.5	4.8	3.2	2.8	2.5	2.2
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-7.6	-7.5	-6.8	-8.0	-9.2	-7.1	-7.2	-7.1	-6.7
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-16.8	-15.1	-13.7	-13.8	-15.4	-13.1	-12.7	-12.2	-11.6
Mallra	% të PBB	-24.3	-24.4	-22.4	-23.0	-21.1	-21.0	-20.3	-19.9	-19.6
Eksporte	% të PBB	6.7	6.9	7.7	6.6	6.0	6.7	7.2	7.3	7.6
Importe	% të PBB	-30.9	-31.3	-30.1	-29.7	-27.1	-27.7	-27.5	-27.3	-27.2
Bilanci i pagesave	% të PBB	0.4	1.6	2.9	-0.6	1.8	0.8	1.6	1.8	1.7
Rezervat valutore	Euro milion	2,945.0	2,995.9	3,399.0	3,359.6	3,586.3	3,701.3	3,940.8	4,216.2	4,497.3
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	7.2	6.7	7.0	6.5	8.6	8.0	8.0	7.9	7.9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore



Lidhja nr. 2/1 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	E M Ë R T I M I	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	407,021	430,397	449,909	460,349	424,123	484,106	517,366	556,876	595,368
I.	Ndihmat	14,639	11,085	8,164	10,609	11,700	20,353	13,994	14,958	13,957
II.	Të ardhura tatimore	369,884	398,629	419,333	426,271	392,590	442,153	480,722	519,018	558,011
II.1	Nga tatimet dhe doganat	275,780	293,386	304,318	304,758	275,560	316,172	346,380	375,495	403,993
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	14,951	18,447	21,863	23,102	21,942	25,426	26,632	28,353	31,631
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	79,153	86,795	93,153	98,411	95,087	100,555	107,710	115,170	122,387
III.	Të ardhura jo-tatimore	22,498	20,683	22,412	23,469	19,834	21,600	22,650	22,900	23,400
	TOTALI I SHPENZIMEVE	433,697	461,410	476,147	491,897	530,115	592,801	568,951	600,484	636,970
I.	Shpenzime Korrente	368,720	382,287	397,345	416,852	420,728	467,769	481,298	505,537	533,607
I.1	Personeli	67,540	72,642	73,582	76,962	76,650	91,834	92,173	93,273	94,906
	Paga	58,215	62,581	62,174	65,636	65,597	71,085	79,159	79,809	80,609
	Kontributi për sigurime shoqërore	9,325	10,061	10,304	10,579	10,575	11,699	11,864	12,064	12,798
	Fondi i veçantë i pagave						250	300	500	500
	Politika të reja pagash						8,000			
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta			1,103	747	478	800	850	900	1,000
I.2	Interesat	36,259	31,904	36,513	35,143	35,060	43,800	49,534	55,822	64,081
	Të brendshme	25,526	21,415	22,838	22,610	22,610	24,300	28,511	31,189	33,758
	Të huaja	10,733	10,489	13,355	12,305	12,450	15,000	16,022	19,132	24,323
	Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj						4,500	5,000	5,500	6,000
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	44,329	43,441	45,498	47,215	49,312	49,888	51,448	55,648	57,715
	Të qeverisë qendrore (operative & mirëmbajtje)					46,218	46,538	47,948	52,148	54,115
	Arsimi i lartë					900	800	900	900	1,000
	Të tjera jashtë limitit					2,194	2,550	2,600	2,600	2,600
I.4	Subvencionet	1,725	2,310	1,883	1,421	1,540	1,550	1,500	1,500	1,550
I.5	Shpenzime për fondet speciale	152,591	162,146	168,249	175,628	178,500	195,171	202,771	211,691	222,124
	Sigurime shoqërore	114,276	119,081	125,364	131,238	133,744	142,265	149,065	156,565	165,298
	Politika të reja pensionesh						2,400	2,500	3,020	3,453
	Sigurime shëndetësore	34,796	39,090	40,154	42,118	42,856	47,506	46,206	46,606	47,873
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	3,519	3,974	2,731	2,272	1,900	3,000	5,000	5,500	5,500
I.6	Buxheti lokal	43,580	46,487	49,615	56,227	51,382	56,826	58,072	61,103	66,131
	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	28,629	28,039	27,753	33,124	25,040	27,050	26,750	28,000	29,500
	Fond i pakushtezuar					17,200	18,450	18,200	19,300	20,500
	Grant Specifik					7,840	8,100	8,000	8,100	8,200
	Transferte për emergjencat civile						500	550	600	800
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	14,951	18,447	21,863	23,102	21,942	25,426	26,632	28,353	31,631
	Taksa të ndara					600	900	900	900	900
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)					2,800	2,700	2,840	2,900	3,100
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura					1,000	750	950	950	1,000
I.7	Transferta të tjera	22,696	23,357	22,004	24,257	28,283	28,700	25,800	26,500	27,100
	Pagesa e papunësisë	691	346	336	505	868	900	600	600	600
	Ndihma ekonomike	20,026	20,714	20,671	20,189	23,535	24,700	21,900	22,200	22,700
	Kompensim për të përndjekurit politikë	1,979	2,298	997	1,199	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Bonusi i lindjeve				2,364	2,880	2,200	2,300	2,700	2,800
II.	Fondi rezervë					12,050	4,000	1,500	3,500	4,000
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave						3,000	1,500	2,500	4,000
	Kosto e zgjedhjeve						1,000		1,000	
	Paketa e mbështetjes sociale nga COVID					12,050				
III.	Shpenzime kapitale	59,478	68,455	78,434	74,993	97,337	121,032	86,153	91,447	99,363
	Financimi i brendshëm	39,118	46,177	51,552	50,641	48,153	57,604	45,041	57,787	61,363
	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta			672	890	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Financimi i huaj	20,360	22,278	26,210	23,462	27,184	34,428	30,112	32,660	37,000
	Nga të cilat: energjia				1,313	1,000	2,300	2,100	2,000	2,000
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:					21,000	28,000	10,000		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)					18,000	28,000	10,000		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (Grant)					3,000				
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (Kredi)									
IV.	Detyrimet e prapambetura									
V.	Të tjera	5,499	9,217	368	53					
VI.	Fond shpronësimit		1,450							
	DEFICITI	-26,676	-31,012	-26,238	-31,549	-105,992	-108,695	-51,585	-43,608	-41,602
	FINANCIMI DEFICITIT	26,676	31,012	26,238	31,549	105,992	108,695	51,585	43,608	41,602
I.	I brendshëm	9,176	1,899	-6,866	40,932	45,432	70,077	-235	8,201	4,703
	Të ardhura nga privatizimi	2,805	418	104	242					
	Hua-marrje e brendshme (neto)	10,602	16,285	19,591	17,846	49,400	49,900	30,000	25,000	20,000
	Të tjera, nga të cilat:	-4,231	-14,804	-26,561	22,844	-3,968	20,177	-30,235	-16,799	-15,297
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	298	-10,962	-30,533	16,624	-3,968	14,177	-30,235	-16,799	-15,297
	Ndryshimi i gjendjes së depozitës sig. Shoq&Shend						6,000			
II.	I huaj	17,500	29,113	33,104	-9,383	60,560	38,618	51,820	35,407	36,899
	Hua afatgjatë (e marrë)	18,780	23,407	83,761	20,493	100,641	24,178	81,952	83,500	87,890
	Per projekte	18,780	23,407	21,232	20,493	19,184	23,428	19,112	20,660	25,000
	Per ri-ndërtimin nga tërmeti									
	Eurobond			62,529		80,457		61,890	61,890	61,890
	Non-hua (Pushetëti vendor)					1,000	750	950	950	1,000
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-408	169	106	-1,729					
	Ripagesat, nga të cilat:	-21,998	-25,769	-51,678	-29,791	-62,745	-40,890	-42,510	-48,093	-50,991
	Eurobond			-25,012		-30,945				
	Maturim					-30,945				
	Para-bletje			-25,012						
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	21,126	31,306	916	1,643	22,664	55,330	12,378		
MEMO:										
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-26,676	-31,012	-26,238	-31,549	-105,992	-108,695	-51,585	-43,608	-41,602
	Balanca korente	38,301	46,660	52,197	43,444	-8,655	12,337	34,568	47,839	57,761
	Balanca primare	9,583	891	10,276	3,594	-70,932	-64,895	-2,052	12,214	22,478
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	10,464	21,904	49,440	16,176	20,144	5,967	36,202	53,001	68,297
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA	1,056,146	1,066,265	1,057,845	1,096,450	1,235,398	1,315,939	1,364,375	1,405,160	1,445,159
	Borxhi publik BRUTO (stok)	1,066,610	1,088,169	1,107,285	1,112,626	1,255,542	1,321,906	1,400,576	1,458,161	1,513,456
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,012,241	1,037,457	1,061,897	1,070,191	1,180,152	1,268,669	1,350,489	1,410,896	1,467,795
	I brendshëm (stok)	530,834	546,939	565,093	582,136	631,536	681,436	711,436	736,436	756,436
	I huaj (stok)	481,407	490,518	496,804	488,056	548,616	587,234	639,054	674,460	711,359
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	54,369	50,712	45,388	42,435	75,390	53,237	50,087	47,265	45,661
	Pushetëti vendor (stok)	901	827	716	582	750	800	850	900	900
	Borxhi publik i garantuar (stok)	53,468	49,885	44,672	41,853	74,640	52,437	49,237	46,365	44,761
	PBB nominal	1,472,480	1,550,644	1,635,715	1,679,284	1,572,269	1,682,637	1,802,981	1,928,848	2,050,773

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Lidhja nr. 2/2 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Nr.	E M È R T I M I	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	27.6	27.8	27.5	27.4	27.0	28.8	28.7	28.9	29.0
I.	Ndihmat	1.0	0.7	0.5	0.6	0.7	1.2	0.8	0.8	0.7
II.	Të ardhura tatimore	25.1	25.7	25.6	25.4	25.0	26.3	26.7	26.9	27.2
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.7	18.9	18.6	18.1	17.5	18.8	19.2	19.5	19.7
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.0	1.2	1.3	1.4	1.4	1.5	1.5	1.5	1.5
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	5.4	5.6	5.7	5.9	6.0	6.0	6.0	6.0	6.0
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.5	1.3	1.4	1.4	1.3	1.3	1.3	1.2	1.1
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.5	29.8	29.1	29.3	33.7	35.2	31.6	31.1	31.1
I.	Shpenzime Korrente	25.0	24.7	24.3	24.8	26.8	27.8	26.7	26.2	26.0
I.1	Personeli	4.6	4.7	4.5	4.6	4.9	5.5	5.1	4.8	4.6
	Paga	4.0	4.0	3.8	3.9	4.2	4.2	4.4	4.1	3.9
	Kontributi për sigurime shoqërore	0.6	0.6	0.6	0.6	0.7	0.7	0.7	0.6	0.6
	Fondi i veçantë i pagave						0.0	0.0	0.0	0.0
	Politika të reja pagash						0.5			
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta			0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.2	Interesat	2.5	2.1	2.2	2.1	2.2	2.6	2.7	2.9	3.1
	Të brendshme	1.7	1.4	1.4	1.4	1.4	1.4	1.6	1.6	1.6
	Të huaja	0.7	0.7	0.8	0.7	0.8	0.9	0.9	1.0	1.2
	Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj						0.3	0.3	0.3	0.3
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	3.0	2.8	2.8	2.8	3.1	3.0	2.9	2.9	2.8
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)					2.9	2.8	2.7	2.7	2.6
	Arsimi i lartë					0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	Të tjera jashtë limitit					0.1	0.2	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	10.4	10.5	10.3	10.5	11.4	11.6	11.2	11.0	10.8
	Sigurime shoqërore	7.8	7.7	7.7	7.8	8.5	8.5	8.3	8.1	8.1
	Politika të reja pensionesh						0.1	0.1	0.2	0.2
	Sigurime shëndetësore	2.4	2.5	2.5	2.5	2.7	2.8	2.6	2.4	2.3
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1	0.2	0.3	0.3	0.3
I.6	Buxheti lokal	3.0	3.0	3.0	3.3	3.3	3.4	3.2	3.2	3.2
633	Vjollca	Lio	Saimreja	2944	31/64	Arë	709.00	91,992.75	136.00	52,419.00	66,617.64			211,029.39	K-34-112-(163-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
634	Bashkim		Lika	2944	12/114	Arë					18,627.52			18,627.52	K-34-112-(163-A)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
635	Bujar		Buzi	2944	12/40	Arë					4,824.00			4,824.00	K-34-112-(147-C)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
636	Artur		Toska	3196	77/9	Arë					68,618.45			68,618.45	K-34-124-(183-B)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
	Jakup		Toska	3196	77/9	Arë					45,745.63			45,745.63	K-34-124-(183-B)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
637	Flutura		Malka	3196	63/7	Arë					2,041.04			2,041.04	K-34-112-(183-A)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
638	Miserdhe	Islam	Lamanjaku	3196	63/3	Arë	837.00	173,259.00	176.00	72,864.00				246,123.00	K-34-112-(183-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
639	Flutur	Halit	Xhaxhaj	3196	64/11	Arë	705.00	145,935.00	149.00	61,686.00				207,621.00	K-34-112-(183-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
640	Burbuqe	Islam	Cepele	3196	64/13	Arë	2,739.00	566,973.00	577.00	238,878.00				805,851.00	K-34-112-(183-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
641	Arben		Beluli	3196	10/10	Arë					11,390.32			11,390.32	K-34-112-(167-C)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
642	Pal		Doda	3301	63/2	Arë	381.00	78,867.00			12,542.52			91,409.52	K-34-111-(161-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
643	Sokol		Agalliu	3301	60/7	Arë	825.00	170,775.00	52.00	21,528.00	28,759.50			221,062.50	K-34-112-(161-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
644	Lulezim	Maliq	Kollundra	3301	81/8	Arë	275.00	56,925.00			3,300.00			60,225.00	K-34-111-(176-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
645	Festim		Dollani	3301	80/6	Arë					20,542.08			20,542.08	K-34-111-(176-B)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
646	Hysen		Cenaj	3301	80/7	Arë					14,738.70			14,738.70	K-34-111-(176-B)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat



																për kulturat
647	Muhamet		Zeço	3301	81/7	Arë					36,492.00			36,492.00	K-34-111-(176-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
648	Andrea		Zeçaj	3301	83/14	Arë					38,530.00			38,530.00		Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
649	Arben		Sako	3301	79/32	Arë					29,108.10			29,108.10	K-34-111-(176-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
650	Vladimir	Luçi	Dimo	3301	79/30	Arë	247.00	51,129.00	80.00	33,120.00				84,249.00	K-34-111-(176-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
651	Kristo		Malo	3301	83/12	Arë					142,477.76			142,477.76	K-34-111-(176-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
652	Gjinovefa	Taulla	Malo	3301	83/11											
	Edjola	Edmond	Kajtazi													
	Aela	Edmond	Malo			Arë	558.00	90,535.50	187.00	60,681.50	7,030.80			158,247.80	K-34-111-(176-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
653	Nasibi		Hamitaj	3301	82/4	Arë					99,484.24			99,484.24	K-34-111-(176-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
654	Vasil		Tanka	3301	111/4	Arë					33,617.90			33,617.90	K-34-111-(161-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
655	Aleksander		Dimo	3301	61/8	Arë					362.12			362.12	K-34-111-(161-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
657	Pandi		Tanka	3301	111/3	Arë					62,449.24			62,449.24	K-34-111-(161-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
	Viktor		Tanka	3301	111/3	Arë					24,979.69			24,979.69	K-34-111-(161-B)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat
658	Ramadan	Gani	Kapo	1992	1/7	Arë			732.00	306774.00				306,774.00	K-34-112-(167-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
	Dashnor		Buqi								25,831.26			25,831.26		Përdoruesi likudohet vetëm për kulturat.
659	Gezim	Gani	Kapo	1992	1/6	Arë			739.00	305,946.00	24,868.62			330,814.62	K-34-112-(167-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
660	Dhimitraq	Gori	Prence	3358	145/8	Arë	2,539.00	411,952.75	628.00	203,786.00				615,738.75	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie dhe se është vendosur kufizim deri në konfirmimin e AMTP-së
	Vangjeli	Gori	Sema													
	Donika	Gori	Gjoni													
	Olimbi	Gori	Goga													
	Vladimir	Gori	Prence													
661	Albert	Peti	Rrapi	3358	146/3	Arë	1,624.00	336,168.00	394.00	163,116.00	184,713.76			683,997.76	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
662	Arçile		Hena	3358	145/4	Arë					4,054.15			4,054.15	K-34-111-(159-C)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat.
663	Bashkim		Spahiu	3532	106/2	Arë					35,107.78			35,107.78	K-34-112-(183-D)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat.
664	Ferdinant		Vrioni	3532	3/5	Arë					263.36			263.36	K-34-112-(184-A)	Përdoruesit likuidohen vetëm për kulturat.
665	Artan	Refat	Zoga	3532	13/25	Arë	370.00	76,590.00			4,440.00			81,030.00	K-34-112-(184-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Sonela	Halit	Zoga													
667	Sami	Ramadan	Gjapi	3532	14/2	Arë	458.00	94,806.00			15,077.36			109,883.36	K-34-112-(184-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
668	Dudi	Ali	Çalamani	3532	14/1	Arë	3,639.00	753,273.00	723.00	299,322.00		128,961.00	1,181,556.00	K-34-112-(184-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie	
	Dhurata	Rushit	Gojashi													
	Nikolin	Rushit	Çalamani													
	Mirjeta	Rushit	Gjapi													



	Valentina	Rushit	Velmishi													
669	Beqar	Kadri	Strumi	3532	17/2	Arë	1,014.00	209,898.00	86.00	35,604.00				245,502.00	K-34-112-(184-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie dhe se AMTP-së është në proces konfirmimi
670	Dervish	Riza	Hatia	3532	2/8	Arë	5,295.00	687,026.25	702.00	188,916.00	63,528.00			939,470.25	K-34-112-(184-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie, pasi AMTP është në proces konfirmimi
671	Fejzi		Musko	3532	16/4	Arë					14,125.50			14,125.50	K-34-112-(184-B)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat.
672	Kristo	Vasil	Mino	1295	471/11	Arë	937.00	233,313.00	208.00	103,584.00	30,846.04		15,505.05	383,248.09	K-34-112-(150-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
673	Rrapush		Halili	1295	474/5	Arë					18,237.68			18,237.68	K-34-112-(165-B)	Përdoruesit likudohen vetëm për kulturat
674	Zeni	Asllan	Çela	1295	471/16	Arë	2,390.00	595,110.00	509.00	253,482.00				848,592.00	K-34-112-(150-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
675	Sako	Sefedin	Kaja	1295	471/15	Arë	1,214.00	302,286.00	257.00	127,986.00	39,964.88			470,236.88	K-34-112-(150-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
676	Kreshnik	Ahmet	Xhindoli	1984	187/5	Pyll			1,704.00	848,592.00				848,592.00	K-34-112-(151-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Bilbil	Ahmet	Xhindoli													
	Krahinor	Ismail	Xhindoli													
	Isa	Ismail	Xhindoli													
	Klarita	Ismail	Xhindoli													
	Seçine	Ismail	Xhindoli													
	Besnik	Gani	Lamçe													
	Myzaferë	Myrteza	Xhindoli													
	Sheçe	Ahmet	Xhindoli													
	Mentor	Ibrahim	Xhindoli													
	Tatjana	Ibrahim	Xhindoli													
	Edlira	Ibrahim	Hoxhaj													
677	Naun	Llazar	Mitri	1984	228/7	Arë	287.00	71,463.00						71,463.00	K-34-112-(166-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
678	Petrit	Islam	Blaca	1984	227/7	Arë	1,498.00	373,002.00						373,002.00	K-34-112-(166-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie. Pasuria figuron e bllokuar nga zyra përbarimorë Lushnjë dhe se ndalohen veprimet mbi pasurinë deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekar, pasi AMTP-ja mungon
	Fatmir		Pirra								52,220.28			52,220.28		Përdoruesi likudohet vetëm për kulturat
679	Refije	Shaban	Velu	1984	225/10	Arë	1,949.00	485,301.00	894.00	445,212.00	64,161.08			994,674.08	K-34-112-(166-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar



																certifikatë pronësie. Ndalohen veprimet mbi pasurinë deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekar. AMTP-ja është në proces konfirmimi
680	Behar	Islam	Blaça	1984	227/8	Arë	5,219.00	1,299,531.00	1,459.00	726,582.00				2,026,113.00	K-34-112-(166-B)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie
	Fatmir		Pirra								181,934.34			181,934.34		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
681	Artan Senka			1984	224/4	Arë					382,530.48			382,530.48	K-34-112-(166-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	TOTALI						455,970.98	81,441,883.56	99,279.59	35,836,830.25	50,561,764.73	2,720,532.20	5,359,337.41	175,920,348.16		

RRETHET: KORÇË, DEVOLL, SKRAPAR, BERAT, FIER DHE LUSHNJË

A - LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA SISTEMI I GAZSJELLËSIT

TOTALI	Sip.m² Marje në përdorim të përkohshëm	Vlera lekë	Sip.m² Servitut	Vlera Lekë	Kultura Vlera Lekë	Objekte Vlera Lekë	Toka Jetime Vlera Lekë	Totali Vlera Lekë	Numri i pasurive që preken
	455,970.98	81,441,883.56	99,279.59	35,836,830.25	50,561,764.73	2,720,532.20	5,359,337.41	175,920,348.16	681

B - LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA SISTEMI I GAZSJELLËSIT ME MINIMUMIN E KOMPENSIMIT

TOTALI	Sip.m² Marje në përdorim të përkohshëm	Sip.m² Servitut	Kultura Vlera Lekë	Totali Lekë	Numri i pasurive që preken
	17,498.43	2,187.90	1,452,980.03	9,285,870.91	162

Totali i Sipërfaqes në m² që kërkohet të merret në përdorim të përkohshëm është	473,469	
Totali i Sipërfaqes në m² që kërkohet për servitutin është	101,467.49	
Totali i kulturave në lekë	52,014,744.76	
Totali i objekteve në lekë	2,720,532.20	
Totali i tokës jetime në lekë	5,359,337.41	
Totali i pasurive	843	
Vlera totale e kësaj Kërkese për Shpronësim për të dyja tabelat 1+2 është:	185,206,219.06	(njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë pikë zero gjashtë) Lekë
Vlera totale në VKM Nr 246 datë 30.03.2016 (Lekë)	185,038,736.36	
Efekt i shtesë i kësaj kërkese për Shpronësim	167,482.70	(njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë) lekë

**VENDIM****Nr. 11, datë 13.1.2021**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI
“RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT
QË KUFIZOHET NGA BULEVARDI
‘BAJRAM CURRI’, BULEVARDI ‘PETRO
NINI LUARASI’, RRUGA ‘TAULANTIA’,
RRUGA ‘ALI DEMI’, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti: “Rikualifikimi urban i bllokut që kufizohet nga bulevardi ‘Bajram Curri’, bulevardi ‘Petro Nini Luarasi’, rruga ‘Taulantia’, rruga ‘Ali Demi’, Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 522 752 181 (pesëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 522 752 181 (pesëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera për shpenzimet procedurale në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në zyrat e Bashkisë Tiranë.

8. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



Llogaritjet përfundimtare për pasuritë që preken nga projekti me objekt “Rikualifikimi urban i bllokut që kufizohet nga blv. ‘Bajram Curri’ – blv. ‘Petro Nini Luarasi’ – rruga ‘Taulantia’ – rruga ‘Ali Demi’”, Tiranë

Nr.	Emër, Atësi, Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z. K.	Nr. pas.	Sip. përgj. truall m²	Sip. e prekur truall m²	Çmimi për truall lek/m²	Sip. përgj. objekt m²	Sip. e prekur objekt m²	Çmimi për objekt lek/m²	Vlera (truall i prekur) lekë	Vlera (objekt i prekur) lekë	Vlera (truall + objekt) lekë	Konfirmim i ASHK-së Tiranë	Shënime
1	Dritan Vakaj	Truall	8150	8/698	325	325	66969				21764925	0	21764925	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	D- Pasuria rivlerësohet në vlerën 16.672.500 lekë, i vlefshme deri në transaksionin e radhës
2	Bardhyl Hasan Mumajesi	Truall	8150	8/680	1623	1442	66969		0		96569298	0	96569298	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	
3	BP. Hysi Ljçi	Truall	8150	8/451	294	265	66969				17746785	0	17746785	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	E- Në favor të shoq. “Sahitaj” sh.p.k.
4	BP. Kaimi, Shtiza, Bellova shoq. “4 A-M” sh.p.k.,	Truall	8150	8/380	938	674	66969				45137106	0	45137106	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2 dt.05.08.2020	D- në bazë të urdhrin nr. 942 prot, dt. 10.9.2008, është bërë korrigjimi i pasurisë nr. 8/380
5	BP Meta	Truall	8150	8/699	153	118	66969				7902342	0	7902342	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	
6	BP Mumajesi,Tafaj,Hyka, ,Kaimi, Cela, Hoxsha, Derhemi, Vakiani,	Truall	8150	8/445	430	136	66969				9107784	0	9107784	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	DTR në referencën 4066, Z.K.8180; D- Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
7	BP Shtiza, Ramilli	Truall	8150	8/471	60	60	66969		0		4018140	0	4018140	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	
8	BP Shtiza, Ramilli	Truall	8150	8/472	159	56	66969				3750264	0	3750264	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	
9	BP Shtiza, Ramilli	Truall	8150	8/473	203	26	66969				1741194	0	1741194	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	
10	BP Shtiza, Bellova, Kaimi, Llupa	Truall	8150	8/378	195	51	66969				3415419	0	3415419	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24..2020	D- Mbi këtë pasuri bie ndërtesa me nr. 8/378-ND, vol. 60, f. 215, përfituar me lege leg. shtesë anësore.
11	BP Shtiza, Bellova, Kaimi, Llupa	Truall	8150	8/379	182	104	66969				6964776	0	6964776	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	
12	BP Shtiza, Bellova, Kaimi, Llupa	Truall	8150	8/377	192	192	66969				12858048	0	12858048	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	
13	Bp. Kërçani, Toro	Truall	8150	8/673	787	787	66969				52704603	0	52704603	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	
14	BP. Ramilli,Shtiza,Bellova,Lela	Truall	8150	8/476	527	61	66969				4085109	0	4085109	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	D – Në bazë të urdhrin me nr. 942 prot., dt. 10.9.2008, është bërë saktësimi i pasurisë nr. 8/476
15	Abedin Shaban Ymeti	Truall	8150	8/234	166.6	166.6	66969	89.00	89	137981	11157035	12280309	23437344	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	PV- Vendimi nr. 396, dt. 20/07/2015 - i AKKP-së
16	BP Shtiza, Ramilli, Bellova	Truall	8150	8/477	255	45	66969				3013605	0	3013605	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	PV mbi këtë truall ka ndërtim pa lege
17	BP. Kërçani,	Truall	8150	8/441	737	6	66969				401814	0	401814	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	D- është mbyllur, certifikata e pronësisë lëshuar me dt. 12.9.2007 00017199, 1.1.2009, i4 për efekt plotësim kërkesës së ref. 17198, E- në favor të shoq. “Vigan” sh.p.k.
18	BP Meta	Truall	8150	8/800	453.4	453.4	66969	39.90	39.9	22731.15	30363745	906,972.89	31270717	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	
19	BP. Tafa, Cela (Tafa)	Truall	8150	8/361	121	35	66969				2343915	0	2343915	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	
20	PPV	Truall	8150	8/235	36.1	36.1	66969				2417581	0	2417581	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	PV mbi këtë truall ka ndërtim pa lege
21	Piro Koste Mani	Truall	8150	8/353	179	114	66969				7634466	0	7634466	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	E- Insk. nr. 811, dt. 21.8.2002
22	B.P.Mumajesi	Truall	8150	8/589	171	110	66969				7366590	0	7366590	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	D-Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. 8/893/ND, vol. 63, f.4



23	BP Meta	Truall	8150	8/799	164.8	14	66969	101.30	0	0	937566	0	937566	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/1, dt. 23.7.2020	
24	Piro Mani	Truall	8150	8/686	328	264	66969	0.00	0	0	17679816	0	17679816	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	
25	Edmond Sotiraq Kushi	Truall	8150	8/688	250	189	66969	0.00	0	0	12657141	0	12657141	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	
26	Mirela Kosta Angjeli	Truall	8150	8/689	628	515	66969	0.00	0	0	34489035	0	34489035	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	PV - Kërkesë nr. 150, dt. 7.5.2015 not. B. Vukaj prona rezervohet 30 dit D - asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të kryej veprime mbi kartelën e pasurisë 8/689, ose të kërkojë të kryej veprime (transaksion) përveç Mirela Angjeli
27	Bardhyl Mumajesi	Truall	8150	8/681	225	225	66969				15068025	0	15068025	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	D- Bllokohet në favor të shoqërisë "Sahitaj Konstruktion" sh.p.k.
28	Sanic Mehmet Shtiza	Truall	8150	8/375	94	94	66969	11.00	0	0	6295086	0	6295086	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	
29	B.P. Ereqi, Meçani	Truall	8150	8/187	735	65	66969	0.00	0	0	4352985	0	4352985	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	PV- mbi këtë truall ka ndërtim pa leje
30	BP Shtiza	Truall	8150	8/233	347	347	66969	180.00	180	137981	23238243	24836580	48074823	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	
31	Hamit Qoshja, Banush Cela, Vijon në vol. 40 f. 223, 224, 225	Truall	8150	8/588	457	173	66969	122.00	0	0	11585637	0	11585637	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	Banesë 3 kat me sip. banimi 122 m², regjistruar me lejen e ndërtimit nr. 33, dt. 18.2.1998, nga Bashkia Tiranë. Pasuria rivlerësohet shumën 11.919.400 lekë
32	BP Mumajesi	Truall	8150	8/590	120	45	66969	0.00	0	0	3013605	0	3013605	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/5, dt. 24.8.2020	
33	Qamil Mustafa Bozaxhiu	Truall	8150	8/452	108	44	66969	0.00	0	0	2946636	0	2946636	Konfirmim me shkresën e ASHK-së me nr. prot. 1394/2, dt. 5.8.2020	
Shuma						7238					484728319	38023862	522752181		

Shënim:

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresat nr. prot.1394/1, datë 23.7.2020, nr. prot. 1394/2, datë 5.8.2020, nr. prot.1394/5, datë 24.8.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt. 3.2.2016.
3. Për objektet e banimit, vlerësimi është bërë sipas çmimit mesatar të shitblerjes për 3 muajt e fundit të objekteve të banimit përcjellë me shkresën nr. prot. 1394/5 datë 24.8.2020, të ASHK-së - së Drejtorisë Vendore Tiranë Veri, me vlerën 137.981 lekë.
4. Për objektin me nr. pas. 8/800, ZK 8150, me funksion shërbimi, vlerësimi është bërë sipas koston së ndërtimit, bazuar në çmimet e EKB-së, për qytetin e Tiranës, ku sipas situacionit të punimeve vlera për m² =22731.15 lekë.



UDHËZIM
Nr. 34, datë 14.9.2020

**PËR MËNYRËN E EMËRIMIT DHE TË
LIRIMIT NGA DETYRA TË
PUNONJËSVE TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE QË TRAJTOHEN ME KODIN
E PUNËS**

Në mbështetje ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Objekt i këtij udhëzimi është rregullimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, që trajtohen me Kodin e Punës.

2. Ky udhëzim përcakton procedurat e rekrutimit, lirimit si edhe transferimeve dhe lëvizjeve paralele të tyre, duke përfshirë edhe rregullat e sjelljes dhe të etikës në vendin e punës të punonjësve të AKPA-s që trajtohen me Kod Pune.

3. Detyrat dhe funksionet e secilit punonjës përcaktohen në rregulloren funksionale të AKPA-s.

Neni 2

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë kuptimin që kanë në legjislacionin e përcaktuar sa më sipër, si edhe në legjislacionin referues “Për nëpunësin civil”.

- Personel i AKPA-s, në të gjithë përmbajtjen e udhëzimit, do të quhen të gjithë punonjësit e AKPA-s, marrëdhëniet e punës të të cilëve trajtohen bazuar në Kodin e Punës.

- Zyrë rajonale, në të gjithë përmbajtjen e udhëzimit, do të quhet drejtoria rajonale e AKPA-s.

Neni 3

**Kuadri rregullator i marrëdhënieve të punës
të personelit të AKPA-s**

Marrëdhëniet e punës me të gjitha kategoritë e personelit të AKPA-s në nivel rajonal dhe vendor, si edhe ato mbështetëse në nivel qendror, rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe të legjislacionit në fuqi.

1. Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) është përgjegjëse për planifikimin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të gjitha nivelet e saj. Planifikimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në nivel rajoni realizohet nga vetë rajoni por pas miratimit nga Drejtoria Qendrore.

2. Drejtori i zyrës rajonale të AKPA-s emërohet dhe largohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të AKPA-s, në përputhje me kriteret dhe procedurat e këtij udhëzimi.

3. Personeli i zyrës rajonale të AKPA-s emërohet dhe largohet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-s, me propozimin e drejtorit rajonal të AKPA-s, në përputhje me kriteret dhe procedurat e këtij udhëzimi.

4. Personeli mbështetës në Drejtorinë Qendrore të AKPA-s emërohet dhe largohet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-s, me propozimin e Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse, në përputhje me kriteret dhe procedurat e këtij udhëzimi.

Neni 4

Detyrat e drejtorit rajonal të AKPA-s

1. Drejtori rajonal i AKPA-s është përfaqësuesi ligjor i drejtorisë dhe drejton veprimtarinë e saj.

2. Drejtori rajonal i AKPA-s kryen çdo detyrë që lidhet me funksionin e tij sipas përcaktimeve të punës dhe rregullores funksionale të AKPA-s.

Neni 5

**Kriteret e marrjes në punë të drejtorit
rajonal të AKPA-s**

Kandidati aplikues për drejtor rajonal i AKPA-s duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:



1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kriteria të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Master shkencor” (ose të barasvlershëm me të);
- b) të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune në menaxhim dhe administrim;
- c) të ketë jo më pak se 5 vjet punë, dhe të paktën 3 vjet në fushën e punësimit;
- d) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;
- e) të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe/ose gjuhëve të tjera (preferohet).

Neni 6

Shpallja e vendit të lirë për pozicionin e drejtorit rajonal të AKPA-s

1. AKPA-ja shpall vendin e lirë për drejtor rajonal, brenda 10 ditëve pune, pasi vendi i drejtorit në një drejtori rajonale mbetet vakant.

2. Njoftimi bëhet në faqen elektronike të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të zyrës rajonale (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të zyrës rajonale, që ka vendin vakant.

3. Shpallja përmban kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për marrjen në punë të drejtorit rajonal të AKPA-s, dokumentet që duhet të paraqiten dhe afatin e aplikimit, që është jo më pak se 5 ditë pune dhe jo më shumë se 15 ditë pune nga data e shpalljes së vendit të lirë.

Neni 7

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimi për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi;
- c) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi (përfshihen ato që janë në proces gjyqësor por të dëshmuara);

i) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të AKPA-s, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje.

Neni 8

Komisioni i vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit (Komisioni) ngrihet nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s dhe përbëhet nga 3 anëtarë:

a) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s (drejtoria përkatëse e programeve aktive e pasive - kryetar i komisionit);

b) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s (nga burimet njerëzore);

c) Një përfaqësues nga zyra rajonale përkatëse;

2. Përpara fillimit të procedurave, anëtarët e komisionit nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit dhe etikës profesionale, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3 të këtij udhëzimi.

3. Detyra e komisionit të vlerësimit është të bëjë vlerësimin me pikë të kandidatëve, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme dhe t'i përcjellë titullarit të AKPA-s listën e kandidatëve të renditur sipas rezultateve të vlerësimit.

4. Komisioni i merr vendimet me shumicë votash.

Neni 9

Procesi i përzgjedhjes së drejtorit

Procesi i përzgjedhjes së drejtorit të drejtorisë rajonale kalon në këto faza.

1. Faza e parë:

a) Njësia e burimeve njerëzore pranë AKPA-s verifikon paraprakisht dokumentacionin e dorëzuar nga çdo aplikant dhe shpall listën paraprake të



kandidatëve të kualifikuar me dokumentacion të plotë, në përputhje me kërkesat e aplikimit.

b) Lista e kandidatëve të kualifikuar, sipas rendit alfabetik, shpallet në faqen zyrtare të AKPA-s, si dhe në një vend të dukshëm të institucionit publik të AFP-së, për të cilin zhvillohet konkurrimi.

c) Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen nga njësia e burimeve njerëzore pranë AKPA-s në adresën e tyre të *email*-it, duke sqaruar dhe arsyet e moskualifikimit.

d) Brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kandidatët që nuk janë kualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Drejtorisë të Përgjithshme të AKPA-s. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj dhe, nëse i rijepet e drejta e kualifikimit, kalon në fazën e dytë.

2. Faza e dytë:

a) Struktura e vlerësimit të kandidatëve është si më poshtë.

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë:

i. arsimimi: 15 pikë;

ii. përvoja në menaxhim: 15 pikë;

iii. njohuritë në fushën e TIK-ut: 10 pikë.

- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë.

i. Në intervistë, ndër të tjera, kandidati vlerësohet për perspektivën e prezantuar prej tij për sa i përket zhvillimit dhe miradministrit të zyrës rajonale të AKPA-s.

ii. Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.

b) Nëse asnjëri nga kandidatët nuk merr në total të paktën 70 pikë, komisioni vendos përfundimin e fazës së vlerësimit pa asnjë kandidat fitues.

c) Komisioni ia komunikon vendimin e përzgjedhjes apo të përfundimit të procedurës pa asnjë të përzgjedhur Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA-s, brenda 24 (njëzet e katër) orëve. Ky vendim dërgohet në AKPA, së bashku me listën e kandidatëve që kanë konkurruar të renditur sipas pikëve.

d) Në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues, AKPA rihap procedurën brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të komisionit.

e) Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve. Në rastet kur ka më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh, ka

prioritet kandidati i cili ka më shumë pikë në intervistën me gojë.

f) AKPA njofton individualisht kandidatët, që kanë konkurruar për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dita që komisioni i njofton vendimin e tij.

g) Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim për rezultatin e pikëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA-s, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

h) Në përfundim të procesit të përzgjedhjes i paraqet Drejtorisë të Përgjithshme të AKPA-s një raport përmbledhës mbi procesin e vlerësimit në përgjithësi.

Neni 10

Emërimi i kandidatit për drejtor rajonal

1. Drejtori i përgjithshëm i AKPA-s, pasi shqyrton raportin e Komisionit të Vlerësimit, i propozon ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësimit për emërimin njërin nga 3 kandidatët e renditur të parët.

2. Emërimi i drejtorit të zyrës rajonale bëhet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive.

3. Njoftimi për emërimin bëhet në të njëjtën mënyrë si shpallja.

Neni 11

Mbarimi i marrëdhënies së punës dhe largimi i drejtorit të drejtorisë rajonale

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të drejtorisë rajonale, bëhet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit;

c) bëhet i paafte për kryerjen e detyrave për arsye shëndetësore;

d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;

e) merret masa disiplinore e largimit nga puna sipas legjislacionit në fuqi.

2. Drejtori i përgjithshëm i AKPA-s i propozon ministrit largimin e drejtorit të drejtorisë rajonale, në rast se drejtori:

a) shkel dispozitat e Kodit të Punës apo legjislacionin në fuqi;



- b) shkel etikën dhe sjelljen në punë;
 - c) ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit;
 - d) ka falsifikuar dokumente zyrtare;
 - e) ka nxitur vartësit e tij të falsifikojnë dokumente zyrtare;
 - f) ka ushtruar dhunë fizike ose psikologjike punonjësve të zyrës rajonale;
 - g) ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të provuara;
 - h) ka marrë ose dhënë ryshfet.
3. Drejtori rajonal ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-s, para se ky i fundit të dërgojë kërkesën për largimin e tij, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.

Neni 12

Detyrat e përgjegjësitë e personelit të zyrës rajonale

1. Personeli i zyrave rajonale, që trajtohet në zbatim të Kodit të Punës, kryen çdo detyrë që lidhet me funksionin e tij, sipas përcaktimeve të punës dhe rregullores funksionale të AKPA-s.
2. Personeli i zyrave rajonale menaxhohet dhe përgjigjet para drejtorit të zyrës rajonale përkatëse.

Neni 13

Kriteret e marrjes në punë të personelit të zyrave rajonale

Kandidati aplikues për punonjës rajonal i AKPA-s duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret e përgjithshme:
 - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
 - c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
 - d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
2. Kriteret e posaçme:
 - a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Master shkencor” (ose të barasvlershëm me të);
 - b) të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune në menaxhim dhe administrim;
 - c) të ketë jo më pak se 5 vjet punë, dhe të paktën 3 vjet në fushën e punësimit;
 - d) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;

- e) të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe/ose gjuhëve të tjera (preferohet).

Neni 14

Shpallja e vendit të lirë për pozicionin e personelit rajonal të AKPA-s

1. AKPA-ja shpall vendin e lirë për personel rajonal, brenda 10 ditëve pune, pasi vendi i mbetet vakant.
2. Njoftimi bëhet në faqen elektronike të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të zyrës rajonale (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të zyrës rajonale, që ka vendin vakant.
3. Shpallja përmban kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për marrjen në punë të personelit rajonal të AKPA-s, dokumentet që duhet të paraqiten dhe afatin e aplikimit, që është jo më pak se 5 ditë pune dhe jo më shumë se 15 ditë pune nga data e shpalljes së vendit të lirë.

Neni 15

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a) letërmotivimi për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi;
 - c) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;
 - d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
 - e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi (përjashtohen ato që janë në proces gjyqësor por të dëshmuara);
 - i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të AKPA-s, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje.



Neni 16

Komisioni i vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit (Komisioni) ngrihet nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s dhe përbëhet nga 3 anëtarë:

a) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s (drejtoria përkatëse e programeve aktive e pasive - kryetar i komisionit);

b) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s (nga burimet njerëzore);

c) një përfaqësues nga zyra rajonale përkatëse;

2. Përpara fillimit të procedurave, anëtarët e komisionit nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit dhe etikës profesionale, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3 të këtij udhëzimi.

3. Detyra e komisionit të vlerësimit është të bëjë vlerësimin me pikë të kandidatëve, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme dhe t'i përcjellë titullarit të AKPA-s listën e kandidatëve të renditur sipas rezultateve të vlerësimit.

4. Komisioni i merr vendimet me shumicë votash.

Neni 17

Procesi i përzgjedhjes së personelit të zyrës rajonale

1. Procesi i përzgjedhjes së personelit të drejtorisë rajonale kalon në këto faza.

Faza e parë:

a) Njësia e burimeve njerëzore pranë AKPA-s verifikon paraprakisht dokumentacionin e dorëzuar nga çdo aplikant dhe shpall listën paraprake të kandidatëve të kualifikuar me dokumentacion të plotë, në përputhje me kërkesat e aplikimit.

b) Lista e kandidatëve të kualifikuar, sipas rendit alfabetik, shpallet në faqen zyrtare të AKPA-s, si dhe në një vend të dukshëm të institucionit publik të AFP-së, për të cilin zhvillohet konkurrimi.

c) Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen nga njësia e burimeve njerëzore pranë AKPA-s në adresën e tyre të email-it, duke sqaruar dhe arsyet e moskualifikimit.

d) Brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kandidatët që nuk janë kualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Drejtorisë të Përgjithshme të AKPA-s. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit

të saj dhe, nëse i rijepet e drejta e kualifikimit, kalon në fazën e dytë.

Faza e dytë:

a) Struktura e vlerësimit të kandidatëve është si më poshtë.

b) Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë:

c) Arsimimi: 15 pikë;

d) Përvoja në menaxhim: 15 pikë;

e) Njohuritë në fushën e TIK-ut: 10 pikë;

f) Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;

g) Në intervistë, ndër të tjera, kandidati vlerësohet për perspektivën e prezantuar prej tij përsa i përket zhvillimit dhe miradministrit të zyrës rajonale të AKPA-s.

h) Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.

i) Nëse asnjëri nga kandidatët nuk merr në total të paktën 70 pikë, komisioni vendos përfundimin e fazës së vlerësimit pa asnjë kandidat fitues.

j) Komisioni ia komunikon vendimin e përzgjedhjes apo të përfundimit të procedurës pa asnjë të përzgjedhur drejtorit të përgjithshëm të AKPA-s, brenda 24 (njëzet e katër) orëve. Ky vendim shoqërohet me listën e kandidatëve që kanë konkurruar të renditur sipas pikëve.

2. Në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues, AKPA rihap procedurën brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të komisionit.

3. Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve. Në rastet kur ka më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh, ka prioritet kandidati i cili ka më shumë pikë në intervistën me gojë.

4. AKPA-ja njofton individualisht kandidatët, që kanë konkurruar për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dita që komisioni i njofton vendimin e tij.

5. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, për rezultatin e pikëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA-s, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda pesë (5) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

6. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes Komisioni i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të AKPA-s një raport përmbledhës mbi procesin e vlerësimit në përgjithësi.



Neni 18

Emërimi i kandidatit për personel në zyrën rajonale

1. Drejtori i përgjithshëm i AKPA-s, pasi shqyrton raportin e Komisionit të Vlerësimit, urdhëron Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s, Sektorin e Burimeve Njerëzore për hartimin e procedurave shkresore për emërimin e njërit nga 3 kandidatët e renditur të parët.

2. Emërimi i personelit të zyrës rajonale bëhet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-s.

3. Njoftimi për emërimin bëhet në të njëjtën mënyrë si shpallja.

Neni 19

Mbarimi i marrëdhënies së punës dhe largimi i personelit të zyrës rajonale

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës së personelit të zyrës rajonale, bëhet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për arsye shëndetësore;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- e) merret masa disiplinore e largimit nga puna sipas legjislacionit në fuqi.

2. Drejtori rajonal i AKPA-s i propozon drejtorit të përgjithshëm të AKPA-s largimin e personelit të drejtorisë rajonale, në rast se:

- a) shkel dispozitat e Kodit të Punës apo legjislacionin në fuqi;
- b) shkel etikën dhe sjelljen në punë;
- c) ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit;
- d) ka falsifikuar dokumente zyrtare;
- e) ka nxitur vartësit e tij të falsifikojnë dokumente zyrtare;
- f) ka ushtruar dhunë fizike ose psikologjike punonjësve të zyrës rajonale;
- g) ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të provuara;
- h) ka marrë ose dhënë ryshfet;

3. Personeli ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-s, para se ky i fundit të fillojë procedurat për largimin e tij, sipas procedurave të

përcaktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Kriteret e marrjes në punë të personelit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s

Kandidati aplikues për personel mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s duhet të përmbushë kriteret si më poshtë, si edhe kriteret e përgjithshme e të posaçme të përcaktuara në legjislacionin përkatës:

1. Kriteret e përgjithshme:
 - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
 - c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
 - d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
 - e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
 - f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.
2. Kriteret e posaçme:
 - a) të ketë nivelin arsimor në fushën e kërkuar në shpalljen për pozicionin përkatës;
 - b) të ketë përvojë në punë, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.

Neni 21

Shpallja e vendit të lirë, dokumentet e aplikimit dhe procesi i përzgjedhjes për pozicionin e personelit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s

1. Shpallja e vendit të lirë, dokumentet e aplikimit dhe procesi i përzgjedhjes për pozicionin e personelit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s, kryhet në të njëjtën mënyrë si tek ai i personelit të zyrave rajonale.

2. Të gjitha shpalljet kryhen në faqen elektronike të AKPA-s, si edhe në një ambient të dukshëm në godinën ku kryen aktivitetin dhe funksionet e veta, Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s.



Neni 22

Komisioni i vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit (Komisioni) ngrihet nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s dhe përbëhet nga 3 anëtarë:

- a) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s (drejtoria përkatëse e Burimeve Mbështetëse - kryetar i komisionit);
- b) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s (nga burimet njerëzore);
- c) një përfaqësues nga Sektori i Burimeve Mbështetëse.

2. Përpara fillimit të procedurave, anëtarët e komisionit nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit dhe etikës profesionale, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3 të këtij udhëzimi.

3. Detyra e komisionit të vlerësimit është të bëjë vlerësimin me pikë të kandidatëve sipas kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme dhe t'i përcjellë titullarit të AKPA-s listën e kandidatëve të renditur sipas rezultateve të vlerësimit. Mënyra e vlerësimit kryhet në të njëjtën mënyrë si tek ai i personelit të zyrave rajonale.

4. Komisioni i merr vendimet me shumicë votash.

Neni 23

Emërimi i kandidatit për personel mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s

1. Drejtori i Përgjithshëm i AKPA-s, pasi shqyrton raportin e Komisionit të Vlerësimit, urdhëron Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s, Sektorin e Burimeve Njerëzore, për hartimin e procedurave shkresore për emërimin e njërit nga kandidatët e renditur të parët.

2. Emërimi i personelit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s, bëhet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-s.

3. Njoftimi për emërimin bëhet në të njëjtën mënyrë si shpallja.

Neni 24

Mbarimi i marrëdhënies së punës dhe largimi i personelit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës së personelit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s bëhet, kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për arsye shëndetësore;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës:

- e) merret masa disiplinore e largimit nga puna.

2. Personeli mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s i shkëput marrëdhëniet e punës me personelin e njësisë mbështetëse, në rast se personi:

- f) shkel dispozitat e Kodit të Punës apo legjislacionin në fuqi;
- g) shkel etikën dhe sjelljen në punë;
- h) ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit;

- i) ka falsifikuar dokumente zyrtare;
- j) ka nxitur vartësit e tij të falsifikojnë dokumente zyrtare;

- k) ka ushtruar dhunë fizike ose psikologjike punonjësv ë zyrës rajonale;

- l) ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të provuara.

2. Ka marrë ose dhënë rryshfet

3. Personeli mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s ka të drejtë të dëgjohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKPA-s, para se ky i fundit të fillojë procedurat për largimin e tij, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Dispozitat e fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen MFE-ja dhe AKPA-ja.

2. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë edhe shtojcat 1, 2 dhe 3.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



SHTOJCA 1 JETËSHKRIMI

Europass
Curriculum Vitae

Vendosni fotografinë.

Informacion personal

Emri Mbiemri

Emri Mbiemri

Adresa

Numri i shtëpisë/apartamentit, emri i rrugës, kodi postar, qyteti, shteti

Telefoni/at

Fiks:

Celular:

Fax

Email

Shtetësia

Data e lindjes

Gjinia

Punësimi i dëshiruar/

Fusha e punësimit

Eksperiencat e punësimit

Data

Vendosni informacione të veçanta për secilën punë të kryer në të kaluarën, duke filluar nga ajo e fundit (shihni udhëzimet)

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Lloji i biznesit ose sektori

Arsimi dhe trajnimet

Data

Vendosni informacione të veçanta për secilin kurs apo trajnim të kryer në të kaluarën, duke filluar nga ajo e fundit (shihni udhëzimet)

Titulli i kualifikimit të arritur

Temat kryesore/aftësitë e mbuluara nga edukimi/trajnimi

Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin

Niveli në klasifikimin kombëtar ose ndërkombëtar (hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)

Aftësitë personale dhe kompetencat



Gjuha e nënës

Përcaktoni gjuhën e nënës (shtoni një gjuhë të dytë, nëse keni gjuhë nëne tjetër, shihni udhëzimet)

Gjuhë të tjera

Vetë vlerësimi

Niveli Evropian (*)

Gjuha

Gjuha

Të kuptuarit				Të folurit				Të shkruarit	
Dëgjim		Lexim		Ndërveprim folës		Prodhim folës			

(*) Korniza evropiane e përbashkët e referimit për gjuhët

Aftësi sociale dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato (hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet)

Aftësi organizative dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato (hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet)

Aftësi teknike dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato (hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet)

Aftësi kompjuterike dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato (hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet)

Aftësi artistike dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato (hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet)

Aftësi të tjera dhe kompetenca

Zëvendësoni këtë tekst me një përshkrim të këtyre kompetencave dhe tregoni se ku janë fituar ato (hiqini nëse nuk janë të vlefshme, shihni udhëzimet)

Leje drejtimi

Përcaktoni këtu nëse posedoni një leje drejtimi automjeti të vlefshme dhe për cilën kategori automjesh. (hiqini nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)

Informacion shtesë

Shtoni këtu çdo informacion tjetër që mund të jetë i vlefshëm, si p.sh., persona kontakti, referenca etj. (hiqini nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)

Aneksë

Listoni materiale ose dokumente të bashkëngjitura me CV-në (hiqini nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)



SHTOJCA 2
FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Emri Mbiemri	
Atësia/Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokument identifikimi (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: i/e padënuari/e dënuar

DEKLARUESI	MARRËSI I VETËDEKLARIMIT
_____	_____
Emër Mbiemër/Firmë	Emër Mbiemër/Firmë/Vulë

AUTORIZIM: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe

SHTOJCA 3
DEKLARATË

Unë i nënshkruari/e nënshkruara _____, me cilësinë e kryetarit/anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, deklaroj sa më poshtë:

1. Aplikuesi për drejtor/nëndrejtor i ofruesit publik të AFP-së nuk është pjesëtar i familjes sime dhe as i afërm (prind, bashkëshort/bashkëshorte, fëmijë, vëlla, motër).
2. Nuk do të ndikohem për arsye personale në kryerjen e detyrave, që parashikon për mua legjislacioni.
3. Nuk do të ndikohem nga persona të tjerë në kryerjen së detyrave, që parashikon për mua udhëzimi.
4. Nuk do të pranoj çfarëdo lloj përfitimi vetjak ose për familjen dhe të afërmit e mi në kryerjen së detyrave që parashikon për mua udhëzimi.
5. Nuk do të nxjerr informacione rreth vendimeve ose të dhënave që udhëzimi parashikon, të cilat nuk janë shpallur zyrtarisht.
6. Nuk do të deklarohej në media për vendime të Komisionit të Vlerësimit pa qenë i autorizuar.
7. Nuk do të paraqes pikëpamjet e mia vetjake si qëndrime të Komisionit të Vlerësimit.

Për sa më sipër, mbaj përgjegjësi të plotë për këto deklaramë:

Emri Mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data e nënshkrimit të deklaratës: _____

**UDHËZIM****Nr. 47, datë 31.12.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 34, DATË 14.9.2020,
“PËR MËNYRËN E EMËRIMIT DHE
TË LIRIMIT NGA DETYRA TË
PUNONJËSVE TË AKPA-s, QË
TRAJTOHEN ME KODIN E PUNËS”**

Në mbështetje ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe të Kodit të Punës së RSH-së,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 34, datë 14.9.2020, “Për mënyrën e emërimit dhe lirimit nga detyra të punonjësve të AKPA-s, që trajtohen me Kodin e Punës”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Neni 13

**Kriteret e marrjes në punë të personelit të
zyrave rajonale**

Kandidati aplikues për punonjës rajonal i AKPA-s duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

2. Kriteret të posaçme për përgjegjësin e sektorit:

- të ketë diplomë të studimeve universitare “Master shkencor” (ose të barasvlershëm me të);
- të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune;
- të ketë njohuri të përditësuar të teknologjisë së informacionit;
- të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të tjera (preferohet).

3. Kriteret të posaçme për specialistin:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit *Bachelor*;

b) të ketë njohuri të përditësuar të teknologjisë së informacionit;

c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.”.

2. Neni 14 ndryshohet si vijon:

“Neni 14

**Shpallja e vendit të lirë për pozicionin e
personelit rajonal të AKPA-s**

1. AKPA-ja shpall vendin e lirë për personel rajonal, pasi vendi i punës mbetet vakant.

2. Njoftimi bëhet në faqen elektronike të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të zyrës rajonale (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të zyrës rajonale, që ka vendin vakant.

3. Shpallja përmban kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për marrjen në punë të personelit rajonal të AKPA-s, dokumentet që duhet të paraqiten dhe afatin e aplikimit, që është jo më pak se 5 ditë pune dhe jo më shumë se 15 ditë pune nga data e shpalljes së vendit të lirë.”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi MFE-ja dhe AKPA-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCËVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM**Nr. 1, datë 7.1.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLA VE
TË DETAJUARA PËR NDREQJEN E
GABIMEVE NË AKTET DHE
VEPRIMET NOTERIALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 107, pika 2, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,



UDHËZOJ:

1. Ndreqja e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale kryhet në rastet dhe sipas procedurës së përcaktuar në pikën 1, të nenit 107, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

2. Ndreqja e gabimit në aktin a veprimin noterial përkatës bëhet në çdo kohë, kryesisht nga noteri, kur konstaton gabime ose me kërkesën e palëve që kanë nënshkruar aktin apo veprimin noterial përkatës.

3. Noteri, pas përfundimit të procesit të nënshkrimit elektronik të dokumentit noterial, nuk mund të ndryshojë të dhënat në sistemin elektronik të Dhomës për këtë dokument.

4. Në rast se noteri konstaton gabime materiale, që nuk cenojnë përmbajtjen thelbësore të aktit, pasi bën rregullimin e gabimit në kopjen origjinale, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 107, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, riskanon dhe regjistron në sistemin elektronik të Dhomës aktin e korrigjuar apo vërtetimin e veçantë për ndreqje gabimi, i cili i bashkëngjitet origjinalit, në varësi të rastit.

5. Akti i korrigjuar dhe i certifikuar sërish elektronikisht merr të njëjtin numër repertori dhe numër koleksioni si akti i mëparshëm. Në kopjen elektronike të aktit, në të cilin është konstatuar gabimi, sistemi elektronik shënon statusin “Korrigjuar”.

6. Në sistemin elektronik të Dhomës mbeten të regjistruar të dyja dokumentet noteriale elektronike.

7. Në rast se lind nevoja për të hequr, shtuar, ndryshuar gabimet e konstatuara në aktin apo veprimin noterial, ndryshimi i të cilave është thelbësor për përmbajtjen e aktit apo veprimit noterial, noteri, pasi të ketë bërë rregullimin në tekst, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 107, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, riskanon dhe regjistron në sistemin elektronik aktin e korrigjuar.

8. Dokumenti në sistem, i korrigjuar dhe i certifikuar sërish elektronikisht, merr të njëjtin numër repertori dhe numër koleksioni si akti i mëparshëm. Në kopjen elektronike të aktit, në të cilin është konstatuar gabimi, shënohet statusi “Korrigjuar”.

9. Në sistemin elektronik të Dhomës mbeten të regjistruar të dyja dokumentet noteriale elektronike.

10. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim në kohë reale në sistemin elektronik të

Regjistrin Noterial Shqiptar të gjitha aktet dhe veprimet noteriale që regjistrohen në të, të cilat janë ndryshuar/korrigjuar, për shkak të ndreqjes së gabimeve dhe vërtetimet përkatëse të veçanta për ndreqje gabimi.

11. Ndaj çdo veprimi ose vendimi të noterit, për ndreqjen e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

12. Për zbatimin dhe ndjekjen e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjona (Saliu)

UDHËZIM
Nr. 2, datë 7.1.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
MË TË HOLLËSISHME PËR
REGJISTRIMIN E VEPRIMEVE DHE
TË AKTEVE NOTERIALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 106, pika 3, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

UDHËZOJ:

1. Aktet dhe veprimet noteriale regjistrohen dhe pasqyrohen njëkohësisht në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe të veprimeve noteriale, manual dhe në atë elektronik, deri në mbajtjen e këtij regjistri vetëm në format elektronik.

2. Në regjistrin e përgjithshëm pasqyrohet e gjithë veprimtaria noteriale, me përjashtim të veprimtarisë që pasqyrohet në regjistrin e testamenteve.

3. Regjistrimi i akteve dhe i veprimeve noteriale manualisht në regjistrin e përgjithshëm kryhet nga noteri, në përputhje me rregullat e parashikuara në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë për evidentimin,



administrimin, ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noterialë, përfshirë formatin e tyre, si dhe formën, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noteriale.

4. Noteri regjistron aktet dhe veprimet noteriale në format elektronik në sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Çdo akt dhe veprim noterial merr në çdo faqe nga sistemi elektronik i Dhomës një numër unik elektronik.

5. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të regjistrimit noterial shqiptar, të gjitha aktet dhe veprimet noteriale që regjistrohen në të, sipas parashikimeve nënligjore në fuqi.

6. Procesi i regjistrimit të akteve dhe të veprimeve noteriale në sistemin elektronik të Dhomës kryhet sipas një rrjedhe të caktuar të fazave të procesimit, të programuara në sistemin elektronik, sipas rregulloreve të punës të miratuar nga Dhoma për këtë qëllim.

7. Aktet dhe veprimet noteriale regjistrohen nga noteri në sistemin elektronik të Dhomës pas kontrollit ligjor të dokumentacionit të sjellë nga klienti dhe/ose verifikimit që noteri kryen në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik.

8. Regjistrimi i akteve dhe i veprimeve noteriale nga noteri bëhet me nivelin më të lartë të kujdesit profesional.

9. Noteri është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara prej tij në sistemin elektronik.

10. Të dhënat e nevojshme për hartimin e aktit dhe të veprimit noterial sigurohen nga noteri nëpërmjet ndërveprimit të sistemit elektronik të Dhomës me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe me sistemet informatike të agjencive shtetërore/publike ose private dhe të sistemit bankar, sipas parashikimeve nënligjore në fuqi.

11. Gjatë procesit të draftimit të dokumentit noterial, të dhënat e regjistruara apo dokumenti noterial mund të ndryshohet në çdo kohë nga noteri.

12. Pas përfundimit të procesit të nënshkrimit elektronik të dokumentit noterial, veprimi ose akti noterial quhet i arkivuar në sistemin elektronik të Dhomës.

13. Noteri, pas momentit të arkivimit të veprimit ose të aktit noterial, nuk mund të

ndryshojë të dhënat në sistem për këtë veprim ose akt, me përjashtim të rasteve të ndreqjes së gabimeve në aktet dhe në veprimet noteriale, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

14. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

UDHËZIM Nr. 3, datë 7.1.2021

PËR MËNYRËN E DIGJITALIZIMIT, ADMINISTRIMIT, RUAJTJES DHE DORËZIMIT TË ARKIVIT NË FORMAT DIGJITAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 142, pika 11, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

UDHËZOJ:

1. Arkivat noterialë administrohen në formatin fizik (*hard copy*) dhe në formatin digjital.

2. Noterët përfundojnë digjitalizimin në tërësi të arkivave noterialë të tyre, brenda 5 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

3. Noterët kryejnë digjitalizimin e të gjitha dokumenteve noteriale, duke nisur që nga dokumenti noterial i parë i kryer, që nga momenti i dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, deri në momentin e fillimit të punës me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

4. Noteri nuk ka detyrim të digjitalizojë dokumentet noteriale, të cilat janë asgjësuar nga ai për shkak të kalimit të afatit ligjor, sipas përcaktimeve nënligjore në fuqi në ditën e regjistrimit të tyre, por ruan dhe skanon procesverbalin përkatës.

5. Digjitalizimi i arkivit noterial nga noterët kryhet nëpërmjet skanimit dhe ngarkimit në



sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare, të dokumenteve noteriale, që kanë në arkivin noterial dhe që nuk janë asgjësuar për shkak të kalimit të afatit ligjor, sipas përcaktimeve nënligjore në fuqi në ditën e regjistrimit të tyre.

6. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim në kohë reale në sistemin elektronik të Regjistrat Noterial Shqiptar të gjitha dokumentet noteriale që regjistrohen në të, si rrjedhojë e digjitalizimit të arkivave noterialë.

7. Noteri kujdeset për ruajtjen në formatin digjital të arkivit noterial dhe mban përgjegjësi për çdo dëmtim të tij.

8. Dokumentet e arkivit të noterit, në format digjital, shfrytëzohen e administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga vetë noteri, personat e parashikuar me ligj ose personat e autorizuar nga noteri dhe nën mbikëqyrjen e tij.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit për njoftimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 5, datë 7.1.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR REGJISTRIN
KOMBËTAR TË TESTAMENTEVE DHE
PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË
DËSHMIVE TË TRASHËGIMISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 140, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Noterët në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përdorin Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të

Dëshmive të Trashëgimisë, për regjistrimin respektivisht të të gjitha testamenteve ose të dëshmive të trashëgimisë ligjore apo testamentare.

2. Në formatin letër:

a) testamentet regjistrohen në regjistrin e testamenteve;

b) dëshmitë e trashëgimisë regjistrohen në regjistrin e përgjithshëm, ku regjistrohen të gjitha aktet dhe veprimet noteriale.

3. Në formatin elektronik:

Regjistri Kombëtar i Testamenteve dhe Regjistri Kombëtar i Dëshmive të Trashëgimisë janë pjesë përbërëse e sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

4. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të regjistrat noterial shqiptar, të gjitha aktet noteriale që regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe në Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë, sipas rregullave të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për mënyrën e ndërlidhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave.

5. Dhoma Kombëtare e Noterisë, në rolin e përdoruesit “Përdorues Regjistri”, ka të drejtë të aksesojë të dhënat e Regjistrat të Testamenteve dhe të Regjistrat të Dëshmive të Trashëgimisë, sipas përcaktimeve të ligjit për noterinë.

6. Ministria e Drejtësisë ka akses të plotë në informacionin që prodhohet, regjistrohet dhe administrohet në regjistrat përkatës, në rolet:

a) lexues;

b) auditues;

c) monitorues;

ç) të prodhimit të statistikave përkatëse.

7. Aksesit, sipas pikës 6, të këtij vendimi, siguron që Ministria e Drejtësisë të mbikëqyrë në kohë reale, përdorimin dhe aksesimin e regjistrave përkatës.

8. Noteri, si përdorues i sistemit elektronik, ka të drejtën e aksesit në të gjitha testamentet dhe dëshmitë e trashëgimisë ligjore apo testamentare, që regjistrohen prej tij në regjistrat përkatës.

9. Noteri kryen regjistrimin e testamenteve dhe të dëshmive të trashëgimisë ligjore apo testamentare me kujdesin më të lartë profesional.



10. Hapat për regjistrimin e një akti “testament” janë të njëjtë me regjistrimin e një shërbimi ekzistues noterial në sistem, si vijon:

a) regjistrohet një akt apo veprim i ri noterial në sistem;

b) zgjidhet një nga shërbimet për testamentet, që janë:

- i. testament - depozitim testamenti;
- ii. testament - përpilimi në zyrë;
- iii. testament - përpilimi në shtëpi;
- iv. revokim testamenti deklarativ; ose
- v. procesverbal i çeljes së testamentit;

c) plotësohen të dhënat e aktit në të gjitha rubrikat e parashikuara në sistem, në të njëjtën mënyrë si për një akt noterial.

11. Hapat për regjistrimin e një akti “dëshmi trashëgimie” ligjore ose testamentare janë të njëjtë me regjistrimin e një shërbimi ekzistues noterial në sistem, si vijon:

a) regjistrohet një akt apo veprim i ri noterial në sistem;

b) zgjidhet një nga shërbimet për dëshmitë e trashëgimisë, që janë:

- i. lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore; ose
- ii. lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare;

c) plotësohen të dhënat e aktit në të gjitha rubrikat e parashikuara në sistem, në të njëjtën mënyrë si për një akt noterial;

ç) kërkimi në regjistrë është i njëjtë me metodën e kërkimit të akteve të tjera noteriale.

12. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

13. Urdhri nr. 356, datë 4.9.2013, i Ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë”, shfuqizohet.

14. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR Nr. 6, datë 7.1.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE AKSESIN NË ARKIVIN ELEKTRONIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Krijimi, administrimi dhe aksesimi në arkivin qendror elektronik të dokumenteve noteriale për të gjithë noterët, për periudhën përpara fillimit të funksionimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë, kryhet sipas rregullave të këtij urdhri.

2. Arkivi qendror elektronik mban në ruajtje, në format elektronik, të gjithë veprimtarinë noteriale të krijuar nga noteri që nga momenti i fillimit të ushtrimit të këtij profesioni, duke përfshirë të dhënat për aktet dhe veprimet noteriale, për testamentet, për dëshmitë e trashëgimisë, dokumentet e skanuara të akteve dhe të veprimeve noteriale, të dhënat për palët, individët dhe subjektet.

3. Arkivi qendror elektronik i dokumenteve për të gjithë noterët, i krijuar për periudhën përpara fillimit të funksionimit të sistemit elektronik të Dhomës, integrohet dhe bëhet pjesë përbërëse e sistemit elektronik të Dhomës.

4. Arkivi qendror elektronik do të vazhdojë në mënyrë kronologjike me aktet noteriale të krijuara dhe të regjistruara në sistemin elektronik të Dhomës që nga data e bërjes funksionale të këtij të fundit.

5. Në çdo rast, të dhënat e regjistruara në sistemin elektronik të Dhomës, sipas këtij urdhri, dërgohen për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të Regjistratës Noterial Shqiptar, sipas rregullave të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për mënyrën e ndërldhjes, nivelin e aksesit dhe bashkëveprimet të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave.



6. Arkivi qendror elektronik bëhet i disponueshëm vetëm pasi të standardizohet dhe të jetë certifikuar elektronikisht.

7. Arkivi qendror elektronik duhet të garantojë elementet e mëposhtme:

a) menaxhimin në mënyrë uniforme dhe me efektivitet të akteve dhe të veprimeve noteriale elektronike;

b) saktësinë dhe leximin e të dhënave që regjistrohen në të;

c) aksesimin e dokumentacionit noterial sa herë që lind nevoja nga personat e autorizuar;

ç) mbrojtjen e dokumentacionit noterial nga aksesit i paautorizuar.

8. Aksesit i subjekteve në arkivin qendror elektronik është, si më poshtë vijon:

a) institucioni administrues i arkivit qendror elektronik është Dhoma Kombëtare e Noterisë;

b) subjekte të interesuara janë Ministria e Drejtësisë dhe noterët.

9. Dhoma Kombëtare e Noterisë ka të drejta të plota administrative mbi arkivin qendror elektronik në rolet e administratorit, raportuesit, audituesit dhe zhvilluesit.

10. Ministria e Drejtësisë i jepet aksesit i nevojshëm në arkivin qendror elektronik, në rolet audituese, për të garantuar mbikëqyrjen e administrimit dhe të përdorimit të këtij arkivi, si dhe prodhimin e statistikave përkatëse.

11. Noterët, si përdorues të arkivit qendror elektronik, kanë të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet noteriale të regjistruara nga zyra e tyre noteriale.

12. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

13. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Salu)

URDHËR
Nr. 7, datë 7.1.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE NË
LIDHJE ME KËRKESAT PËR KRIJIMIN
DHE PËRDORIMIN E DOKUMENTEVE
ELEKTRONIKE NOTERIALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 95, pika 3, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Krijimi dhe përdorimi i dokumentit elektronik noterial bëhet në përputhje me parashikimet e këtij urdhri dhe të legjislacionit për dokumentin elektronik, nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, duke siguruar që këto dokumente të jenë të disponueshme, autentike, të aksesueshme gjatë ciklit jetësor të tyre.

2. Parashikimet e këtij urdhri zbatohen nga çdo noter, i cili lëshon dokumente të vërtetuara në formë elektronike.

3. Çdo noter, për përdorimin e dokumentit elektronik noterial, duhet të sigurojë:

a) zbatimin e standardeve dhe të parimeve në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve elektronike noteriale nga sistemi elektronik i Dhomës Kombëtare të Noterisë (sistemi elektronik), si dhe të garantojë regjistrimin e dokumentit elektronik noterial në sistemin elektronik të regjistrimit noterial shqiptar;

b) ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe të dokumenteve që ruhen në sistemin elektronik; mbrojtjen e të dhënave personale që përmban dokumenti elektronik noterial, në përputhje me politikën dhe rregullat e miratuara nga Dhoma Kombëtare e Noterisë për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Dokumenti elektronik noterial krijohet nga noterit dhe është pjesë e sistemit elektronik të Dhomës.

5. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim në kohë reale në sistemin elektronik të



regjistrin noterial shqiptar dokumentin elektronik noterial, sipas parashikimeve nënligjore në fuqi.

6. Çdo dokument elektronik noterial identifikohet nëpërmjet një numri elektronik, i cili nënkupton pajisjen në çdo faqe të dokumentit noterial me barkodin unik korrespondues, të gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi elektronik i Dhomës.

7. Numërtimi i repertorit për veprimet noteriale dhe numërtimi i repertorit dhe i koleksionit për aktet noteriale bëhen nga sistemi elektronik i Dhomës, sipas rendit kronologjik të vendosjes së këtyre numrave, si dhe regjistrohen në regjistrin e përgjithshëm të veprimeve dhe të akteve noteriale që mbahet në formë manuale.

8. Përdorimi i dokumentit elektronik, në komunikimin midis noterit, në cilësinë e dërguesit dhe kërkuesit (marrësit), bëhet me pëlqim të dyanshëm.

9. Marrësi, i cili ka pranuar përdorimin dhe qarkullimin e dokumentit elektronik, nuk mund të refuzojë dokumentin elektronik në mënyrë të njëanshme, vetëm për faktin që ai është përgatitur, përdorur dhe qarkulluar në formë elektronike.

10. Dokumenti elektronik përmban nënshkrimin elektronik të kualifikuar, bazuar në certifikatën e kualifikuar, që është e vlefshme që në çastin e krijimit të nënshkrimit.

11. Nënshkrimi elektronik është procesi i vetëm që realizon certifikimin e dokumentit noterial, i cili i jepet klientit apo palëve të interesuara. Çdo dokument elektronik noterial duhet të jetë i certifikuar elektronikisht nga noteri nëpërmjet nënshkrimit elektronik, që sigurohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

12. Nënshkrimi elektronik krijohet nga noteri dhe të gjitha të dhënat e lidhura me krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar administrohen personalisht nga noteri, sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

13. Nënshkrimi elektronik i krijuar nga noteri përmban emër, mbiemër, firmë, si dhe kohën e krijimit.

14. Forma e jashtme e paraqitjes së një dokumenti elektronik noterial duhet të përmbushë të njëjtat kritere si dokumenti shkresor.

15. Përpara dërgimit të dokumentit elektronik noterial te marrësi, duhet të kontrollohet që nënshkrimi elektronik bashkëngjitur tij është i vlefshëm dhe i verifikueshëm.

16. Dokumenti elektronik noterial konsiderohet i dërguar, kur dërgohet:

a) personalisht nga noteri apo nga personi i autorizuar nga noteri për të kryer veprimet që kanë të bëjnë me dërgimin e dokumentit elektronik noterial; ose

b) në mënyrë të automatizuar nga sistemi kompjuterik i noterit.

17. Koha kur dokumenti elektronik noterial del nga sistemi kompjuterik i noterit dhe hyn në sistemin kompjuterik, që nuk është nën kontrollin e noterit apo nën kontrollin e një personi të autorizuar prej tij, konsiderohet si koha e dërgimit të dokumentit elektronik noterial.

18. Dokumenti elektronik noterial konsiderohet se është marrë, kur:

a) merret personalisht nga marrësi; ose

b) merret nga personi i autorizuar nga marrësi, ose

c) në mënyrë të automatizuar në sistemin kompjuterik të marrësit ose të personit të autorizuar prej tij.

19. Koha kur dokumenti elektronik hyn në sistemin kompjuterik të marrësit dhe/ose në sistemin kompjuterik të personit të autorizuar prej tij, konsiderohet si kohë e marrjes së dokumentit elektronik noterial.

20. Koha e dërgimit dhe e marrjes së dokumentit noterial konsiderohet si pjesë e veçantë e strukturës së dokumentit elektronik dhe ndalohe ndryshimi i saj.

21. Pas marrjes së dokumentit elektronik, marrësi e trajton atë në të njëjtat procedura me të cilat trajtohet edhe dokumenti shkresor, i përcaktuar në legjislacionin për arkivat.

22. Vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik kryhet nga noteri, në përputhje me rregullat dhe procedurat për vërtetimin në letër të dokumentit elektronik të përcaktuara në ligjin për dokumentin elektronik.

23. Kopja në letër, e vërtetuar si kopje e dokumentit elektronik noterial, duhet të mbajë bashkëlidhur shënimin e noterit: “Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik noterial”.

24. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.



25. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

VENDIM
Nr. 240, datë 21.12.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ERDY ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC
“KALIS” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2138 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/10 prot., datë 16.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 205, datë 4.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Kalis”, me vendndodhje në përroin e Shmilit, Kuterman, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/42 prot., datë 4.12.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1232/1 prot., datë 11.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1232/2 prot., datë 14.12.2020, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi, në respektim të rregullores sipërcituar, është tërësisht i plotësuar.

Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd (datë 21.9.2025) shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Shoqëria, pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullësor publik të sipërfaqes së përcaktuar më sipër, duhet ta depozitojë atë në ERE.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 25.4.2022) shoqëria të depozitojë në ERE të rifreskuar në datë, jo më vonë se një muaj pas rinovimit të afatit të saj.

- Kontrata nr. 1945 rep., nr. 885/3 kol., datë 4.9.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Kalis’, me kapacitet prodhues 1958 kw, në ujërat rrjedhës të lumit të Shmilit, dege e Lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, e lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.



Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Erdy Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kalis”, me kapacitet të instaluar 2138 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Pas përfundimit të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd (datë 21.9.2025), shoqëria duhet të depozitojë kontratën me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

3. Shoqëria, pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullosor publik të sipërfaqes së përcaktuar me sipër, ta depozitojë atë në ERE.

4. Pas përfundimit të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 25.4.2022), shoqëria të depozitojë lejen me afate të rifreskuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

5. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petril Ahmeti

VENDIM
Nr. 241, datë 21.12.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC
ZALL XHUXHË” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“XHUXHË 1”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 3487 kw, DHE HEC
“XHUXHË 2”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1254 kw, DHE ME
KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR
4741 kw**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, dhe nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/12 prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 16.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, me vendndodhje në kaskadën e përroit të Zall Xhuxhë, degë e Lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me “Njoftimin për licencim” nr. 62/58 prot., datë 17.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,



rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1165/1 prot., datë 26.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “HEC ZALL Xhuxhë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1165/2, datë 3.12.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar kryesisht, dhe më poshtë veçojmë dokumentacionin i cili mbetet i pa plotësuar:

- neni 9, pika 2, germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik). Pavarësisht shpjegimit që ka dhënë shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., ajo duhet të përcjellë licencën e drejtuesit të saj teknik elektrik, dhe si e tillë vlerësohet që kjo kërkesë të vendoset si kusht në këtë vendim, për depozitimin e saj në ERE, brenda 3 muajve nga marrja e vendimit të licencimit;

- neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet përkatëse, për rrjedhojë vlerësohet që kjo kërkesë të vendoset si kusht në këtë vendim, për depozitimin e tij në ERE, brenda 3 muajve nga marrja e vendimit të licencimit;

- neni 9, pika 4.1.4, germa “a”. Studimi i fizibilitetit. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE studim fizibiliteti dhe në vijim vlerësohet që kjo kërkesë e rregullores të vendoset si kusht në këtë vendim, për depozitimin e tij në ERE, brenda 3 muajve, të vendimit të licencimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në përfundim të afatit të lejes për përdorim të burimit ujor (datë 25.7.2023), do t’i kërkohet

shoqërisë të depozitojë në ERE, lejen e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Në përfundim të afatit të kontratës për dhënien në përdorim të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullësor në administrim të Bashkisë Mirditë, në funksion të ndërtimit të HEC “Zall Xhuxhë” (datë 19.6.2028), i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE lejen e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE “Deklaratën mjedisore”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 2945/1 prot., datë 26.3.2019, me nr. 266 identifikimi dhe nr. 15 vendimi, për personin juridik “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin: Ndërtim i HEC Zall Xhuxhë 1 dhe Zall Xhuxhë 2”.

- Kontrata nr. 10329 rep., nr. 3323 kol., datë 9.9.2013, “Kontratë koncesioni për ndërtimin e hidrocentraleve Zall Xhuxhë nr. 1 dhe Zall Xhuxhë nr. 2” e lidhur midis METE-s (sot MIE) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gloris Construction” sh.p.k. dhe “Gjoka Construction” sh.p.k., ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Nga sa konstatuar, kjo shoqëri ka humbur 7 vite e tre muaj nga koncesioni i saj.

- Në këto kushte, në zbatim të nenit 5, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, vlerësohet se shoqëria nuk mund të licencohet me një afat përtej atij koncensionar. Periudha e mbetur e koncesionit është 27 vite e 9 muaj dhe si e tillë edhe licenca e lëshuar nga ERE do të mbaje të njëjtin afat.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1 Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9



muaj, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi të depozitohet në ERE:

- i. licencën për drejtuesin teknik elektrik;
- ii. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;
- iii. studimin e fizibilitetit.

2. Në përfundim të afatit të lejes për përdorim të burimit ujqor (25.7.2023), shoqëria të depozitohet në ERE lejen e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

3. Në përfundim të afatit të kontratës për dhënie në përdorim të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullosor në administrim të Bashkisë Mirditë, në funksion të ndërtimit të HEC “Zall Xhuxhë 1” dhe HEC “Zall Xhuxhë 2” (19.6.2028), shoqëria të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të saj.

4. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petril Ahmeti

VENDIM

Nr. 244, datë 21.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK, PËR VENDOSJE HIPOTEKË DHE BARRË SIGURUESE/PENG NË FAVOR TË BANKËS INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, MBI PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME TË KRIJUARA APO QË DO TË KRIJOHEN NGA SHOQËRIA KONCESIONARE “SEKA HYDROPOWER” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20 pika “a”; nenit 44, pika “1”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 6, nenit 7 dhe nenit 8, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6, të “Kushteve të licencës”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/18 prot., datë 18.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1260, datë 11.12.2020, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për autorizim për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k., bazuar në kontratën e koncesionit me nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013, të formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Sekë” dhe “Zais”, ndryshuar me



kontratën shtesë “Për disa ndryshime dhe shtesa në kontratën e koncesionit”, me nr. 2247 rep., 1095 kol., datë 18.8.2017.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 470, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, për një periudhë 30-vjeçare.

- Aplikimi i shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. është pjesërisht i plotësuar dhe veçojmë dokumentacionin e munguar si më poshtë:

Nenin 7, “Përbërja e kërkesës për transferim”

Pika 1. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- Germa “a”. Një ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE, ekstraktin historik të saj, por në vijim do t’i kërkohej ta depozitojë.

- Germa “c”. Gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE pasqyrat financiare të saj, por në vijim do t’i kërkohej depozitimi i tyre në mënyrë që të analizohej gjendja financiare, si dhe aftësia likuiduese.

- Germa “d”. Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre vjetëve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka përcjellë sa kërkon kjo pikë e rregullores, por në vijim do t’i kërkohej ta plotësojë.

- Germa “P”. Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka bërë me dije efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e licencuar, por në vijim do t’i kërkohej të bëjë me dije në ERE.

- Germa “g”. Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka informuar mbi efektet e pritshme, por në vijim do t’i kërkohej që të bëjë me dije ERE-n.

- Germa “i”. Deklaratë me shkrim e personit (subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të

garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE deklaratën e bankës, sipas kërkesës së kësaj pike të rregullores, por në vijim do t’i kërkohej depozitimi.

- Germa “j”. Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka deklaruar në aplikim nëse ka pasur ose jo transferime të kryera më herët nga ana e saj. Në vijim do t’i kërkohej shoqërisë ta përcjellë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

3. Subjektet koncesionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen (konkretisht neni 17, pika 1), për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve: plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka përcjellë në ERE marrëveshjet, kontratat që ka nënshkruar me Intesa Sanpaolo Bank, në lidhje me këtë transferim, por nuk ka përcjellë asnjë korrespondencë me MIE-n, në lidhje me këtë transferim, pra informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI), në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

Evidentojmë se, në lidhje me miratimin/informimin e MIE-s për këtë barrësim, në nenin 17.3 të kontratës së koncesionit nr. 6144 rep., nr. 2021 kol., datë 22.6.2009, citohet, se: “Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose koncesionari, ose filiali i tij, ka të drejtë të vendosë hipotekë, peng apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve, si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshjeje financimi me çdo palë financuese, me kusht që hipoteka, peng apo barra tjetër, si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t’i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të koncesionarit në këtë kontratë”.

Ajo që vihet re nga ky përcaktim është, se shoqëria nuk ka detyrimin të informojë MIE-n dhe as të marrë miratimin paraprak të saj në rastin e vendosjes së hipotekës, pengut apo barrësimit mbi asetet.

Megjithatë, në vijim, për nevoja të kësaj vendimmarrje dhe referuar kërkesës së rregullores së ERE-s (pika 3) shoqëria duhet të informojë MIE-n, në lidhje me këtë transferim, për rrjedhojë



vlerësojmë që t'i kërkohej shoqërisë, nëse ka pasur korrespondenca me MIE-n, në lidhje me këtë transferim.

6. Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre: plotësuar pjesërisht. Shoqëria "Seka Hydropower" sh.p.k. nuk ka specifikuar në kërkesën e saj nevojën për mosbërjen publike të pjesëve të caktuara të dokumentacionit, por në vijim do t'i kërkohej të shprehet në lidhje me këtë pikë të rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Seka Hydropower" sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare "Seka Hydropower" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 249, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALB WIND ENERGY" SHPK, "PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 13, DATË 28.1.2008", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e

energjisë elektrike dhe gazit natyror"; pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7, të kushteve licencës nr. 53, seria NPM08, "Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike" (projekti "Visu" dhe projekti "Terpan"), të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/6 prot., datë 14.12.2020 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria "Alb Wind Energy" sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 13, datë 28.1.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet VISU, me fuqi 140 mw, dhe projekti "Trepan", me fuqi 85 mw, me kushtet e tij respektive.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik "Grykëderdhja e Shkumbinit Terpan", si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 13.9.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 139, datë 15.11.2013.

- Në vlerësim të sa më sipër, ERE, me vendimin nr. 89, datë 9.6.2016, "Mbi kërkesën e shoqërisë Alb Wind Energy sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 53, seria NPM08P, për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (projekti "Visu" dhe projekti "Terpan")", të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar", ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "Alb Wind Energy" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të Ndërtimit, Instalimit, Shfrytëzimit të Centraleve Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik "Projekti 'Visu' dhe projekti 'Terpan'".



2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. nr. 53, seria NPM08P dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008.

- Në vijim të shtyrjeve ndër vite, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike, si një teknologji e re për vendin; argumentet shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e MIE-s me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.1.2015, ku iu kërkua të prononcohet, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, MEI bën me dije, se: VKM-ja nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave. Gjithashtu për këtë projekt, gjate kësaj kohe nuk ka pasur shprehje interesi nga palë të treta.

- Në vlerësim të sa më sipër, ERE, me vendimin nr. 5, datë 10.1.2018, “Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 49, seria NPM07P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, ka vendosur ndër të tjera:

Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, “Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale, shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për projektet ‘Visu’ dhe ‘Terpan’”, të ndryshuar, mbajtëse e licencës nr. 53, seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, deri në datën 15.11.2019.

- Në kuadër të afateve të vendosura në vendimin e sipërcituar, shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 701 prot., datë

5.11.2019, ka kërkuar nga ERE shtyrjen me 48 muaj të afatit të plotësimit të kushteve të licencës, për të cilën Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Alb Wind Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar”, vendosi ndër të tjera:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet “Visu” dhe projektin “Terpan”, deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Të ushtrojë monitorim pranë subjektit “Alb Wind Energy” sh.p.k. për të evidentuar, për të dokumentuar e për të shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Alb Wind Energy’ sh.p.k., të ndryshuar”, si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 143, datë 4.12.2020, u ngrit grupi i punës për monitorimin e kushteve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar. Nga dokumentacioni i depozituar nga ana e shoqërisë dhe nga monitorimi i kryer konkludojmë, se:

- Për sa i përket kushtit të vendosur në paragrafin e parë të pikës 1, të vendimit 13/2008, të ndryshuar, sigurimi i dokumenteve të pronësisë nga ana e shoqërisë është deklaruar se disponon të tilla, por për shkak të izolimit nga COVID-19 nuk ka staf në zyrë dhe si e tillë do t’i dërgojë ato në ERE në një kohë të dytë, pas përfundimit të pandemisë. Në lidhje me këtë dokumentacion, nga ana e shoqërisë nuk ka pasur asnjë reagim deri më sot dhe si e tillë ky kusht i vendimit mbetet ende i paplotësuar.

- Për sa i përket kushtit të vendosur në paragrafin e dytë të pikës 1, të vendimit nr. 13/2008, të ndryshuar, paraqitja e studimit të fizibilitetit, shoqëria ka bërë me dije se po përgatit një studim të ri fizibiliteti (i cili do të zëvendësojë atë që ka depozituar më parë në ERE), që do të



mund të tregojë që ky projekt është i financueshëm dhe me efektivitet dhe beson se ky studim i ri do të përfundojë brenda 60 ditëve. Deri më sot nuk rezulton që nga ana e shoqërisë të jetë depozituar studimi i ri i fizibilitetit dhe si i tillë ky kusht i vendimit është ende i papërditësuar/plotësuar nga shoqëria.

- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 2, marrëveshja me OST-në, shoqëria nuk ka përcjellë në ERE marrëveshje për pikën e lidhjes me OST sh.a., por vetëm shprehje mendimi të OST sh.a. për pikën e lidhjes. Ajo që vihet re është, se OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1182/1 prot., datë 18.2.2020, ka rikonfirmuar edhe njëherë mendimin e saj për mundësinë e lidhjes me rrjetin, duke i bërë me dije shoqërisë që të plotësojë dokumentacionin teknik të nevojshëm deri në nënshkrimin e marrëveshjes sipas procedurave aktuale në fuqi. Në të tilla rrethana ky kusht i vendimit mbetet ende pa plotësuar nga shoqëria.

- Sipas deklarimeve të shoqërisë rezulton, se pjesën më të madhe të investimeve e ka realizuar në 2 vitet e para të licencimit (2008–2009) dhe se ato konsistojnë në instalimin e katër matësve për fuqinë e erës, në lartësinë 60 m dhe se njëkohësisht janë përgatitur të gjitha studimet lidhur me pajisjen me licencat e tjera përkatëse, si ajo e lidhjes me rrjetin elektrik, impaktit mjedisor (VNM). Sa deklarohej nga shoqëria nuk rezulton të jetë dokumentuar në ERE nëpërmjet dokumentacionit përkatës dhe vihet re se përgjatë periudhës në vijim e deri më sot, nuk është kryer ndonjë investim konkret për zhvillimin në terren të centralit me erë.

- ERE iu drejtua MIE-s me shkresën nr. 714 prot., datë 19.5.2020, “Mbi aplikimet për shtyrje afati të plotësimit të kushteve të licencave të lëshuara për parqet eolike”, duke i bërë me dije se pranë Entit Rregullator të Energjisë janë depozituar kërkesat e shoqërive, të cilat janë licencuar nga ERE për ndërtimet e parqeve eolike në zona të ndryshme të vendit, për shtyrje të afatit të plotësimit të kushteve të vendimeve përkatëse të licencimit dhe i ka kërkuar informacion në lidhje me zonat ku aktualisht janë licencuar këto shoqëri, nëse janë paraqitur pranë MIE-s propozime apo shfaqje interesi nga subjekte të tjera.

- MIE, në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk

është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Në vijim të këtij komunikimi, ERE, me shkresën nr. 1071 prot., datë 28.8.2020, iu drejtua të gjithë të licencuarve për prodhim energjie elektrike nga parqet eolike, duke i bërë me dije qëndrimin e MIE-s dhe i ka kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja e kësaj shkrese të informohet në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushteve respektive të licencimit.

- Shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k. nuk ka kthyer përgjigje ndaj kësaj korrespondence.

- Siç rezulton nga konkluzionet e monitorimit, evidentojmë se shoqëria nuk ka bërë të gjitha përpjekjet që varen nga vullneti i saj për plotësimin e kushteve të vendimit të licencimit nr. 13, datë 28.1.2008, por vetëm ka deklaruar se ka hasur një sërë pengesash, të natyrës financiare dhe administrative, cilat kanë bërë të pamundur plotësimin në afat të kushteve të vendosura në vendimin nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara, për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga qeveria shqiptare për distancimin social, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, monitorimi dhe finalizimi i praktikës ka pasur vështirësitë e veta për rakordimin, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 83, datë 4.5.2020, të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. nr. 53, seria NPM08P.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe MIE-n për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e tij, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 252, datë 21.12.2020

“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ERS-08” SH.P.K., PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 63, DATË 13.6.2008, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.135/3 prot, datë 14.12.2020 dhe info shtesë me nr 47-1-1 prot, datë 14.12.2020 të Drejtorisë së Licensimit, Autorizimeve dhe Mbyqyrjes, lidhur me “Kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008 të ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ERS-08” sh.p.k., është licencuar nga ERE me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik Kavajë, me kusht zbatimit të sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike, si me kushtet respektive.

- Në vijim të këtij licencimi ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik Kavajë Kryevadh 1, si dhe prodhimit të energjisë elektrike prej tyre me vendimet:

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 46, datë 28.5.2009,

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 135, datë 15.11.2013,

- Në vlerësim të sa më sipër ERE me vendimin nr. 85 datë 9.6.2016, “Mbi kërkesën e shoqërisë ERS-08 sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licenses nr. 59, Seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë nga parku eolik Kavajë, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar”, ka vendosur:

1. Rrezimin e kërkesës së shoqërisë “ERS-8” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 59, Seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë, të dhënë me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., nr. 59, Seria NPM08P, të dhënë me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

- Në vijim të sa më sipër, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike si një teknologji e re për vendin; argumentat shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e MIE me shkresën nr. 102/4 Prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr.14 prot, datë 7.1.2015, ku i'u kerkua të prononcohet, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të ketyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, MEI bën me dije se: VKM, nr. 1701, datë 17/12/2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt konçisioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qënë në fuqi në kohën e miratimit të ketyre licencave. Gjithashtu, për këtë projekt, gjatë kësaj kohe nuk ka patur shprehje interesi nga palë të treta.

- Me urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr.1, datë 6.1.2020, u ngrit Grupi i Punës për monitorimin e



kushteve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar.

- Pas kryerjes së monitorimit shoqëria është shprehur se nuk ka komente apo objeksione në lidhje me konstatimet e monitorimit, sipas informacionit nr. 47/1 prot., datë 3.4.2020, të përcjellë në Bord nga grupi i punës, i cili është pjesë integrale dhe e pandashme e këtij relacioni.

- MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria Shqiptare për distancimin social me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, u bë i vështirë dhe finalizimi i këtij monitorimi në kohë sipas përcaktimeve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2020, të Bordit të ERE-s.

- Referuar përfundimeve të monitorimit, dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të këtij monitorimi, është e nevojshme të rishikohet i gjithë ky dokumentacion, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nga ana e shoqërisë.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67 të Kodit të Procedurave Administrative, u pa e arsyeshme që për arsye të verifikimit të plotë të dosjes të dokumentacionit të depozituar në ERE dhe gjetjeve të monitorimit, shtyrja me 30 ditë e vendimmarrjes.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. vendimin nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 259, datë 28.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “BORIE – LURË 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/1 prot., datë 24.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “Ageta” sh.p.k., me shkresën nr. 8 prot., datë 17.12.2020, dhe protokolluar në ERE me nr. 1288 prot., datë 21.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Borie Lurë 1”, me vendndodhje në ujërat e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër.

- Shoqëria “Ageta” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.12.2014, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare



të Regjistrimit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Ageta” sh.p.k. rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, dhe pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, plotësuar.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 9.4.2022), do t'i kërkohej shoqërisë ta depozitonte në ERE të rifreskuar, një muaj pas rinovimit të afatit të saj.

- Duke qenë se Urdhri mbi vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kullësor, është dokument i cili lidhet me pronësinë shoqëria pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullësor publik të sipërfaqes së përcaktuar më sipër, ta depozitonte atë në ERE.

- Kontrata nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Borie Lurë 1’, me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrenjve të kurores së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër”, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Ageta” sh.p.k. dhe “Bajrami N” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohej paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik).

- germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.),

Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5:

- germa c, leja mjedisore,

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Boria Lura 1”; me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Faqe | 1599



VENDIM

Nr. 260, datë 28.12.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/2 prot., datë 24.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “Ageta” sh.p.k., me shkresën nr. 8 prot., datë 17.12.2020 dhe protokolluar në ERE me nr. 1288 prot., datë 21.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Ageta” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.12.2014, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Ageta” sh.p.k. rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar.

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.),

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8;

- germat: “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gwh/sipas viteve);

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti);

- germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur);

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 261, datë 28.12.2020

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË
8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E
SHOQËRISË ‘OPERATORI I
KOMBINUAR I GAZIT NATYROR’
ALBGAZ SHA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 6–11, të “rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 100, datë 5.8.2015, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 129, datë 31.10.2015; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/3 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 2.7.2020, vendosi:

1. Pika 2, e vendimit nr. 221, datë 20.12.2019, ndryshon si më poshtë: “- Shoqëria “Albgaz” sh.a., të dorëzojë për miratim në ERE, deri në datën 20.12.2020, programin e përputhshmërisë së përshtatur sipas atij, të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.”.

2. Pika 5 dhe 6, bëhen pika 5 me këtë përmbajtje: “- Shoqëria “Albgaz” sh.a., të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, brenda datës 20.12.2020.”.

3. Shoqëria “Albgaz” sh.a., të depozitojë në ERE deklaratat e audituesve financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i gazit natyror’ Albgaz sh.a.”.

- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2017, të ndryshuar, që lidhet me depozitimin në ERE, për miratim, të programit të përputhshmërisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar në ERE këtë program (të përshtatur sipas tij e të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77/2017), pra dokumentacionin e plotë dhe shterues lidhur me këtë pikë. Duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit të certifikimit nr. 179/2017, i ndryshuar.

- Për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2020, të ndryshuar, në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46 (10), të ligjit “Për sektorin e gazit natyror” dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar në ERE shkresën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim implementimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore në sektorin e gazit natyror, me qëllim përmbushjen e kushteve të vendimit të certifikimit nr. 179/2017. Ky kusht mbetet ende i paplotësuar për shkak se nuk varen nga vullneti i shoqërisë “Albgaz” sh.a.

- Në pritje të vendimarrjes nga ana e MIE-s, lidhur me ndryshimet ligjore, si dhe duke marrë në konsideratë situatën e krijuar për shkak të pandemisë COVID-19, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendimit të plotësimit të kushteve të vendimit të certifikimit nr. 179/2020, deri në datën 20.6.2021.

- Në konsideratë të sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 2.7.2020, dhe duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria ka bërë përpjekjet e saj për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 179/2017, të ndryshuar, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror’ AlbgaZ sh.a.”, të ndryshuar.

2. Shoqëria “AlbgaZ” sh.a. të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i gazit natyror’ AlbgaZ sh.a.”, i ndryshuar, brenda datës 20.6.2021.

3. Shoqëria “AlbgaZ” sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë MIE-s, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 262, datë 28.12.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBGAS’ SHA, NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR, DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBGAS’ SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015,

“Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 142/4 prot., datë 24.12.2020, mbi një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 2.7.2020, vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë ‘AlbgaZ’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë ‘AlbgaZ’ sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Dokumentacioni i cili duhet të plotësohet nga shoqëria “AlbgaZ” sh.a. deri në datën 20.12.2020, sipas vendimeve të Bordit nr. 187/2017 dhe nr. 188/2017 sipërcituar, është si më poshtë:

- pajisja me lejet dhe autorizimet mjedisore (neni 9, pika 1, germa “d”, “vi”), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”;

- depozitimi në ERE i një certifikatë sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

- Në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë “AlbgaZ” sh.a., nr. 144/1 prot., datë 17.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1283 prot., datë 18.12.2020, “Kërkesë për shtyrje afati të vendimit



mbi licencimin e shoqërisë ‘ALBGAZ’ sh.a.”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.6.2021.

- Kjo kërkesë vjen nga pamundësia e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për të plotësuar brenda afateve kushtet e vendimeve të licencimit, në referim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 4.3.2020, për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, si dhe masave që vazhdojnë të merren në vend për parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të nevojshëm është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 2.7.2020 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, vlerësojmë se shoqëria ndodhet në kushtet e pamundësisë për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2021, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2021, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë Albgaz sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të

bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 263, datë 28.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR, “ALBGAZ” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të pikës 76, të programit të përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017; të nenit 19, pika 1, germa “F”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/7 prot., datë 24.12.2020, të përparuar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, Albgaz sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 143/1 prot., datë 28.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 1123/2 prot., datë 4.11.2020, ka depozituar për miratim “Programin e përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror”.

- Në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, përcaktohet se OST-ja krijon një program të përputhshmërisë, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, i cili miratohet nga ERE, si dhe metodën për monitorimin e përputhshmërisë me këtë program. Programi i përputhshmërisë



përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputhshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputhshmërisë.

- Në pikën 76, të “Programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017, përcaktohet se ky program duhet të miratohet me vendimin e organit përgjegjës të kompanisë OST dhe, brenda 5 (pesë) ditëve pas përshtatjes së tij ky vendim duhet të dorëzohet në ERE për miratim. Ky program duhet të hyjë në fuqi ditën tjetër pas miratimit nga ERE.

- Në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 109, datë 2.7.2020, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 221, datë 20.12.2019, ‘Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 179, datë 8.11.2017, ‘Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i kombinuar i gazit natyror’ AlbgaZ sh.a., të ndryshuar’”, është përcaktuar se shoqëria “AlbgaZ” sh.a., duhet të dorëzojë për miratim në ERE, deri në datën 20.12.2020, programin e përputhshmërisë së përshtatur sipas tij, të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE për miratim programin e përputhshmërisë brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109/2020.

- “Programi i përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror”, dërguar nga “AlbgaZ” sh.a. është kryesisht në përputhje me programin e përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.77, datë 26.5.2017, ndërsa pikat për të cilat evidentohet nevoja e diskutimit me “AlbgaZ” sh.a. dhe palët e interesit, janë si vijon:

- Kudo në tekst, akronimi OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit) të zëvendësohet me “AlbgaZ” sh.a.,

- në kreun II, “Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST”, pika 5, duhet të shpjegohet struktura e aksioneve të kompanisë OST, duke përfshirë dhe marrëdhënien e aksionerëve të OST-së me kompani të angazhuara me prodhimin

dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike, nga ato që kanë ndonjë interes komercial;

- në kreun II, “Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST-së”, pika 6, duhet të shpjegohet ndarja dhe pavarësia e organeve publike të cilat janë të autorizuar të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë, dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër. Sa më sipër, vlerësohet që të parashikohet dhe në programin e përputhshmërisë së AlbgaZ sh.a.;

- në kreun II, “Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST”, pikat 6–10, duhet të bëhet renditje e saktë e përcaktimeve në program;

- në kreun III, “Ndarja dhe pavarësia e OST”, germa “B”, “Pavarësia drejtuese e OST-së”, pika 15, duhet të përcaktohen qartë drejtuesit e OST-së, sipas funksioneve që mbajnë në organet apo strukturën e “AlbgaZ” sh.a., për të cilët është e detyruar që të ndiqen kriteret e përcaktuara në pikat 15.1–15.6;

- në kreun VII, “Dispozita të përgjithshme”, pika 76, duhet të përcaktohet dhe asambleja e përgjithshme, si organ drejtues i shoqërisë që miraton programin e përputhshmërisë, pas miratimit nga Këshilli mbikëqyrës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, ‘AlbgaZ’ sh.a.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 264, datë 28.12.2020

**MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË ERE-s NR. 140, DATË
21.8.2020, “MBI RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR.
86, DATË 12.5.2020, ‘MBI REFUZIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË ‘SOLARIS
POWER’ SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 3, të nenit 104 dhe të nenit 113, të “Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 8 dhe nenit 10, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.142/6 prot., datë 24.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 21.8.2020, ‘Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, ‘Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘Solaris Power’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 12.5.2020, vendosi të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 140, datë 21.8.2020, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit nr. 86/2020, dhe të licencojë shoqërinë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me kushtet përkatëse, duke ndaluar dhe fillimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE iu drejtua shoqërisë me *email* (në postën elektronike të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë) dhe me shkresën nr. 1191, datë 11.11.2020, duke i kërkuar informacionin përkatës në lidhje me ecurinë e plotësimit nga ana e saj të kushteve si më sipër. Përveçse me postë fizike, kjo shkresë iu dërgua

shoqërisë në datën 11.11.2020, dhe në postën elektronike të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë. Nuk rezultoi që *email* apo shkresa të jenë kthyer mbrapsht.

- Shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. nuk ka kthyer përgjigje për sa kërkuar nga ERE. Po ashtu nuk rezultoi që shkresa apo *email* të jenë kthyer mbrapsht.

- Shoqëria nuk ka dokumentuar në ERE asnjë përpjekje për plotësimin në afat të kushteve të vendimit nr. 140/2020.

- Në nenin 113, të KPA-së është parashikuar se organi që nxjerr aktin administrativ, ka dhe tagrin ta anulojë, shfuqizojë apo ndryshojë atë akt, duke nxjerrë një akt të ri me shkrim, sipas formës ligjore të përcaktuar, ndaj ERE ka tagrin dhe kompetencën për të rishikuar kryesisht një akt të nxjerrë nga vetë ajo.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 21.8.2020, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, ‘Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘Solaris Power’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike””.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Solaris Power” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

**VENDIM****Nr. 265, datë 28.12.2020**

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR
MONITORIMIN E TREGUT TË GAZIT
NATYROR” NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 16, pika 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, me nr. 142/8 prot., datë 24.12.2020, “Për miratimin e rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 164 datë 22.10.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur, “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftit të ‘Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror’ në Shqipëri”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u bënë publikimet në faqen e *web*-it të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE-s nr. 62/31 prot., datë 29.10.2020, si dhe njoftimi për botimin në Fletoren Zyrtare me shkresën e ERE nr.68/37 prot., datë 3.11.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 11.11.2020.

- Për të marrë opinionet e palëve të interesuara, referuar vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 164, datë 22.10.2020, ERE, me anë të shkresës nr. 1161 prot., datë 2.11.2020, iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), “Anio Oil & Gas” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a., “Albgaz” sh.a., “C.G.C” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “TAP AG Albania” sh.p.k., Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike me qëllim që palët e interesuara të shprehnin, brenda 30 ditëve, opinionet dhe komentet e tyre.

- Në përfundim të afateve, me qëllim dhënien apo marrjen e mendimeve ose propozimeve në lidhje me draftin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror”, rezultoi se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr.7788/1 prot., datë 16.12.2020, protokolluar në

ERE me nr.1161/2 prot., datë 17.12.2020, ka shprehur dakordësinë e saj.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me anë të një *email*-i zyrtar më datë 9.12.2020, parashtron disa komente dhe pyetje për: nenin 1, pika 5; nenin 2, pika 1, shkronja “d”; nenin 2, pika 3; nenin 4, pika 1; nenin 5, pika 1; nenin 5, pika 2; nenin 10, pika 2; nenin 12, pika 4; nenin 12, pika 5; nenin 14; nenin 20, pika 1; të cilat u shqyrtuan në relacionin përkatës.

- Nuk rezultoi të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palët e tjera të interesit në lidhje me përmbajtjen e draftit të “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” me të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.

2. Hyrja në fuqi e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” do të jetë 1 korrik 2021.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 267, datë 28.12.2020**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
TË MIRATUAR “KUSHTET PËR TË
LICENCUARIN E NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK,
PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR”
NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e



detyrimin të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”; të nenit 92, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/10 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për të miratuar “Kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.

konstatoi se:

- Në nenin 23, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. /2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e një licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: “f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj”.

- Në nenin 92, pika 3, në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE përcakton dhe miraton rregullat operationale për furnizuesit që kryejnë furnizimin e gazit natyror si një detyrim të shërbimit publik. Furnizuesi i Shërbimit Publik duhet t’u ofrojë klientëve, të cilët kanë të drejtën e shërbimit publik, shërbimin e furnizimit konform kontratës standarde të furnizimit të miratuar nga ERE, në përputhje me nenin 95, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.

- Këshilli i Ministrave, me VKM-në nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”, përcakton kushtet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga ERE për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, për të licencuarin në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit me gaz natyror të klientëve të vegjël, përfshirë klientët familjarë.

- Siç përcaktohet në nenin 4, pika 4.1, të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, detyrimi i shërbimit

publik ndaj një të licencuarit vendoset nga ERE, në përputhje me nenin 89, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe lehtësisht të verifikueshme, duke garantuar barazinë e aksesit për shoqëritë e gazit natyror të vendeve anëtare të BE-së, ose palëve kontraktuese të komunitetit të energjisë, për klientët vendas, dhe duke mos penguar hapjen e tregut të gazit natyror dhe të drejtën e furnizuesve të tjerë të gazit natyror për të furnizuar klientët në Republikën e Shqipërisë.

- Këto rregulla/kushte operationale për Furnizuesin e Shërbimit Publik, FSHP-në, me gaz natyror, që i vendosen të licencuarit të ngarkuar me këtë detyrim nga ERE, janë përpiluar në përputhje me parimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me synimin arritjen e një tregu konkurrues, të sigurt e të qëndrueshëm, të gazit natyror, nga pikëpamja mjedisore, pa qenë të diskriminuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 68, datë 22.4.2020, mbi miratimin e “Kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror”, dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 166, datë 22.10.2020, për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për të miratuar “Kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.

2. Drejtoria e Gazit natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



KUSHTET PËR TË LICENCUARIN E
NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT PUBLIK PËR SEKTORIN E
GAZIT NATYROR NË SHQIPËRI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Këto rregulla/kushte kanë për qëllim të përcaktojnë dhe të sigurojnë shërbimin publik të furnizimit me gaz natyror nga i licencuari i ngarkuar me këtë detyrim që ushtron aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit me gaz natyror të klientëve të vegjël, përfshirë klientët familjarë, në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Shërbimi Publik i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Publik, i cili siguron të drejtën e furnizimit me gaz natyror për klientët që përfitojnë nga shërbimi publik në Republikën e Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente e jodiskriminuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga rritjet e paarsyetuara të çmimit duke synuar në arritjen e një tregu konkurrues, të sigurt e të qëndrueshëm të gazit natyror nga pikëpamja mjedisore, pa qenë të diskriminuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre, siç parashikuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 2

Baza ligjore dhe ndërrvarësia

1. Këto rregulla/kushte hartohen në mbështetje të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 23, pika “F”, dhe të neni 92, pika 2; të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”.

2. Kjo rregullore ka ndërrvarësi, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në tërësi, si dhe në veçanti me kodet e rrjetit për sektorin e gazit natyror.

Neni 3

Termet dhe përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë akt normativ duhet të kuptohen dhe interpretohen sikurse janë të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Shpërndarjes, si dhe në referencë dhe analogji të rregulloreve të miratuara nga Bordi i ERE-s.

2. Çdo term i përdorur në këto rregulla, për të cilin nuk ekziston një përkufizim sipas pikës së mësipërme, do të interpretohet në kontekstin dhe frymën e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 4

Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik

1. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit është i detyruar të furnizojë klientët e gazit natyror në mënyrë proporcionale, qartësisht të krahasueshme, transparente dhe me çmime jodiskriminuese dhe të rregulluara, në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe duke iu referuar zonave, të cilat janë pjesë e planit rregullues, të miratuar sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe lehtësisht të verifikueshme, duke garantuar barazinë e aksesit, për shoqëritë e gazit natyror, të vendeve anëtare të BE-së ose palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, për klientët vendas, dhe duke mos penguar hapjen e tregut të gazit natyror dhe të drejtën e furnizuesve të tjerë të gazit natyror, për të furnizuar klientët në Republikën e Shqipërisë.



3. Duke qenë i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit, si pjesë e detyrimit të shërbimit publik, operatorët e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror janë të detyruar të furnizojnë klientët fundorë sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit me gaz natyror”.

4. Detyrimi i shërbimit publik për të licencuarin vendoset duke vlerësuar kapacitetin teknik, financiar dhe organizativ të tij dhe duhet të marrë në konsideratë nëse i njëjti i licencuar po ofron shërbimin publik në të njëjtën zonë ose për një kategori konsumatorësh në momentin e vendosjes së këtij detyrimi. Vendimi për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik duhet:

a) të përcaktojë qartë detyrimet që ka i licencuari;

b) të përcaktojë qartë të licencuarin e gazit natyror, të cilëve u është vendosur detyrimi i shërbimit publik, kur ky detyrim vendoset mbi një ose me shumë subjekte të licencuara, që ushtrojnë aktivitet në sektorin e gazit natyror;

c) të specifikojë natyrën e të drejtave ekskluzive ose të veçanta të caktuara për të licencuarin, duke arsyetuar se pse ato janë të nevojshme;

ç) të përcaktojë kategorinë e klientëve, territorin dhe periudhën për të cilën është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

d) të shoqërohet me vlerësim, në lidhje me tregun, cilësinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë;

dh) të identifikojë kostot e të licencuarit, ndaj të cilit do të vendoset detyrimi i shërbimit publik;

e) të përcaktojë një mekanizëm transparent dhe jodiskriminues për mënyrën se si do të mbulohen kostot, nëse kostot nuk mbulohen nga tarifa përkatëse;

f) të bëjë të qartë financimin dhe kriteret për llogaritjen e mbulimit financiar që do të përfitojnë të licencuarit, subjekte të këtij shërbimi publik.

Neni 5

Detyrimi i shërbimit publik të furnizimit

1. Detyrimi i shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror vendoset duke marrë në konsideratë interesin publik në

ushtrimin e këtij aktiviteti, për kushtet që lidhen me:

a) sigurinë e furnizimit;

b) cilësinë e shërbimit;

c) tarifat për kryerjen e një detyrimi të shërbimit publik;

d) mbrojtjen e mjedisit;

e) mbrojtjen e konkurrencës;

f) eficiencën e energjisë;

g) çdo rrethanë tjetër që ndikon në interesin publik;

h) ndryshimet klimaterike;

i) përdorimin e burimeve vendase të gazit natyror;

j) furnizimin me çmim të rregulluar të gazit natyror, të miratuar nga ERE;

k) mbrojtjen e shëndetit, të jetës dhe të pronës së njerëzve;

2. Çdo detyrim i shërbimit publik, i vendosur nga ERE, do të përfshihet brenda 1 (një) muaji në termat dhe kushtet e licencës së të licencuarit. I licencuari, i ngarkuar me detyrim të shërbimit publik, duhet të marrë të gjitha masat, në mënyrë që të përmbushë detyrimet e shërbimit publik, në përputhje me vendimin përkatës të ERE-s.

Neni 6

Furnizimi i gazit natyror me çmim të rregulluar

1. Detyrimi i shërbimit publik të furnizimit vendoset në mënyrë që klientët të furnizohen me gaz natyror nga Furnizuesi i Shërbimit Publik, me çmime të rregulluara, që miratohen nga ERE në përputhje me nenin 92, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe duhet të pasqyrojë kostot e arsyeshme të shërbimit.

2. Çmimi i gazit natyror për sasi të ofruara do të jetë i rregulluar në përputhje me përcaktimet në pikën 5, të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, “Miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”.

3. Çmimi i gazit natyror, me të cilin Furnizuesi Shërbimit Publik shet gazin natyror te klientët që përfitojnë nga ky shërbim, do të përfshijë kostot reale të furnizimit me gaz natyror, duke përfshirë koston e investimeve të nevojshme, një normë të



përshtatshme të kthimit të investimit, kostot e importeve, kostot e shërbimeve të furnizimit dhe të borxheve të këqija.

Neni 7

Rregullimi i furnizimit me gaz natyror

1. Furnizuesi i Shërbimit Publik duhet t'u ofrojë klientëve të cilët kanë të drejtën e shërbimit publik, shërbimin e furnizimit konform kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 22.10.2020.

2. Furnizuesi, i cili ka detyrimin e shërbimit publik, duhet:

a) të sigurojë furnizim si një shërbim publik për të gjithë ata klientë fundorë që gëzojnë të drejtën nga ky lloj furnizimi;

b) të kryejë furnizimin në kuadër të shërbimit publik, ekskluzivisht, sipas tarifave të përcaktuara nga ERE, të cilat bazohen në kushte të rregulluara;

c) të ndërmarrë masa që të realizojë një furnizim të sigurt, të besueshëm dhe cilësor të këtyre klientëve fundorë, sipas kuadrit të shërbimit publik;

ç) të ndërmarrë masa për aplikimin e tarifave më të pranueshme të gazit natyror, për furnizimin e klientëve fundorë, në kuadër të shërbimit publik, të cilat janë pjesë përbërëse e tarifave në bazë të kushteve të rregulluara.

3. Furnizuesi nuk duhet t'u devijojë kontratat standarde (ose tip) dhe duhet të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet sipas kompetencave të tyre të plota.

4. Klientët familjarë, shoqëritë e vogla dhe, kur është e zbatueshme, klientët në nevojë, në bazë të nenit 90, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", në vend që të transferohen te furnizuesit e mundësisë së fundit, furnizohen nga furnizuesi, sipas detyrimit të shërbimit publik, pa qenë nevoja e paraqitjes së ndonjë aplikimi të veçantë prej tyre, nëse furnizuesi i tyre ka dalë nga tregu i gazit natyror për shkak të rrethanave, jashtë kontrollit të tyre, dhe se klientët e sipërpërmendur kanë humbur furnizimin me gaz natyror pa ndonjë formë mbrojtjeje, pavarësisht faktit nëse klientët në fjalë janë përballur me një dalje të paplanifikuar, të planifikuar apo për shkelje të rënda, nga ana e furnizuesit, në mospërmblidhje të detyrimeve të tij.

5. Kontrata për furnizimin me gaz natyror për klientët fundorë, në kuadër të ofrimit të shërbimit të furnizimit publik, konsiderohet e lidhur në datën në të cilën furnizimi është bërë fizikisht, ku klientët në fjalë janë furnizuar, pavarësisht faktit nëse kanë bërë kërkesë apo jo, në përputhje me rregullat e zbatueshme dhe kushtet e parashikuara në rregulloren "Për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 30.1.2018.

6. Furnizuesi, i cili ka detyrimin e ofrimit të shërbimit publik, duhet t'i dorëzojë klientit fundor kontratën e lidhur me shkrim, brenda 8 ditëve nga dita në të cilën ka filluar furnizimi.

7. Furnizuesi i Shërbimit Publik duhet të mbajë një regjistër për numrin e klientëve të furnizuar prej tij dhe një regjistër të posaçëm me të çdo të dhënë të këtyre klientëve, i cili duhet të përditësohet rregullisht dhe duhet t'i komunikohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ERE-s. Në faqen e internetit të ERE-s do të publikohen të dhënat që nuk shkelin parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Neni 8

Çmimi i rregulluar për furnizimin e klientëve fundorë nga Furnizuesi i Shërbimit Publik

1. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit është i detyruar të furnizojë klientët e gazit natyror sipas përcaktimeve të pikës 5, të VKM-së nr. 533, datë 25.7.2019, "Miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror", me çmime të rregulluara, në të gjithë territorin e Shqipërisë, në përputhje me këtë vendim.

2. Çmimi i gazit natyror, i vendosur nga Furnizuesi i Shërbimit Publik, për kategoritë e klientëve të përcaktuara në nenin 92, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" caktohet nga ERE në përputhje dhe me metodologjitë e miratuara nga ERE.

3. ERE do të shqyrtojë mundësinë për të mbajtur çmimin e rregulluar, si një masë të nevojshme për të siguruar shërbimin publik për klientët, duke siguruar që kushtet e tregut të



zhvillohen në atë mënyrë që klientët të cilëve iu është dhënë e drejta për shërbimin publik, mund ta blejnë gazin natyror në treg me çmime të arsyeshme të parregulluara.

4. ERE duhet të publikojë “Metodologjinë për llogaritjen dhe analizimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë të shërbimit publik të gazit natyror”.

Neni 9

Pagesa për të siguruar shërbimin publik

1. Pagesat për mbulim financiar, format e tjera të rimbursimit dhe të drejtat ekskluzive, të bëra për shoqëritë e gazit, për ofrimin e detyrimeve të shërbimit publik, bëhen në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Kostot e realizuara nga çdo i licencuar, për ofrimin e detyrimeve të shërbimit publik, pranohen si të justifikueshme kur tarifat për shërbimet e ofruara janë të miratuara nga ERE, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. ERE do të vendosë për shpërndarjen e kostove të detyrimeve të shërbimit publik, të vëna në bazë të këtij neni, për klientët fundorë, në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente.

3. ERE do të vendosë për shpërndarjen e kostove të detyrimeve të shërbimit publik, të vëna në bazë të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015, për klientët fundorë, në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Kompensimi për këto kosto nuk duhet të kalojë shumën e shpenzuar për kryerjen e detyrimeve të shërbimit publik, të zbritura nga të ardhurat e fituara për ofrimin e shërbimit. Kompensimi mund të përfshijë një fitim të arsyeshëm. Çdo kompensim për të licencuarin, për përmbushjen e detyrimit të ofrimit të shërbimit publik, duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin paraprak nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

4. Në rast vendosjeje të detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, të cilit i shkatohen kosto shtesë, që nuk janë përfshirë në tarifën e përcaktuar nga ERE, i licencuari do të kompensohet financiarisht apo në formë të tjera të rimbursimit dhe të të drejtave ekskluzive në përputhje me përcaktimet e pikave 9 e 10, të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

5. Shpërndarja e kostove shtesë të detyrimeve të shërbimit publik, të shkaktuara ndaj një të licencuari, të vëna në bazë të këtij neni, do të vendoset nga ERE, për klientët fundorë, në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente.

6. Asnjë të licencuari nuk do t'i kërkohej të ndërtojë një rrjet në një zonë ku nuk ka rrjet në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo bëhet pa paragjykuar detyrimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të lidhur klientët fundorë të rrjetit të tyre, sipas detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi.

7. Çdo investim i bërë nga shoqëria e transmetimit ose e shpërndarjes, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, për kapacitetet e reja të transmetimit ose shpërndarjes, në funksion të plotësimit të kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, do të trajtohet si një detyrim i shërbimit publik, në lidhje me sigurinë e furnizimit.

8. Kostot përkatëse mbulohen nëpërmjet tarifave të miratuara nga ERE, në bazë të një metodologjie që miraton ERE, lidhur me përcaktimin dhe llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, duke pasur në konsideratë, por pa u kufizuar në, kriteret që kanë të bëjnë me:

a) aplikimin e metodës RoR (*Rate of Return*), që i lejon operatorit të rrjetit të mbulojë kostot e justifikuara;

b) vlerësimin e përcaktimit të kostove të rrjetit, që do të jenë ato aktuale, të amortizimit, të kthimit mbi kapitalin dhe të të ardhurave të zbritshme nga ato të lejuara, sipas përcaktimeve përkatëse që do të bëhen;

c) marrjen në konsideratë nga operatori i rrjetit vetëm të atyre kostove apo komponentëve të tyre që kanë të bëjnë me marrjen nga të tretët të shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit, njësoj sikur t'i kryente vetë ato, si dhe paraqitjen nga operatori i rrjetit të dokumenteve dhe provave për secilën nga këto kosto;

d) raportimin pa vonesë te rregullatori nëse ndodhin shpenzime apo të ardhura të jashtëzakonshme.

9. Në kuadër të realizimit të veprimtarive të tyre, të licencuarit, subjekte të detyrimeve të shërbimit publik, deklarojnë ofrimin e shërbimeve të tilla, të cilat do të monitorohen nga ERE.



Neni 10

Klientët në nevojë

1. ERE mund të vendosë përsëri detyrimin e shërbimit publik, për të siguruar shërbim publik me çmime të rregulluara, për kategoritë e klientëve në nevojë, të përcaktuara në nenin 97, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, që përfitojnë nga shërbimi publik në të ardhmen, duke provuar që kjo masë është e nevojshme dhe e arsyetuar.

2. Klientët familjarë, që kanë fituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 97, të ligjit nr. 102/2015, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit publik të furnizimit. Furnizuesi, i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, lidh, brenda 5 ditëve nga dita e regjistrimit të klientit në nevojë, te operatori i sistemit të shpërndarjes, kontratën për furnizimin me gaz natyror.

3. Të gjitha shpenzimet e bëra nga furnizuesi, në lidhje me kushtet e veçanta të furnizimit për këtë kategori klientësh, gjatë një viti, të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, mbulohen nga tarifat e atij viti. Në vitin pasardhës mund të bëhet rregullimi i të ardhurave në varësi të performancës së vitit të mëparshëm.

Neni 11

Detyrimi për lidhjen në rrjet

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të përmirësojë dhe të zgjerojë sistemin e shpërndarjes, me qëllim sigurimin e lidhjes së çdo klienti fundor, i cili nuk është i lidhur në sistemin e shpërndarjes, nën termat, kushtet dhe tarifat e vendosura nga ERE.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron një shpërndarje të qëndrueshme dhe eficiente të gazit natyror, në përputhje me kushtet e licencës dhe me rregullat e ERE-s.

3. Pavarësisht nga detyrimi i përcaktuar në pikën më sipër, Operatori/ët e Sistemit të Shpërndarjes nuk do të ketë detyrimin për të ndërtuar apo zgjeruar sistemin e shpërndarjes në një zonë, në të cilën nuk ka ekzistuar rrjet para vendosjes së këtij detyrimi të shërbimit publik, përveç kur kërkohet nga rregulloret e miratuara nga ERE, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe për zonat, të cilat janë pjesë e një plani territorial,

kombëtar ose lokal, të miratuar në përputhje me parashikimet e legjislacionit specifik për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 12

Cilësia e shërbimit

1. Standardet e cilësisë së furnizimit, duke përfshirë kërkesat e nevojshme të vazhdimësisë së furnizimit në një nivel të qëndrueshëm të presionit nga furnizuesi shërbimit publik, të përfshira në rregulloret dhe kodet ekzistuese, do të konsiderohen detyrime të shërbimit publik.

2. Kushtet e cilësisë së furnizimit, të parashikuara në pikën më sipër, në lidhje me secilin prej të licencuarve, miratohen nga ERE, në përputhje me standardet evropiane të shërbimit të furnizimit, duke pasur në konsideratë, por pa u kufizuar në, kërkesat për:

a) sigurimin e shërbimit cilësor të transmetimit të gazit natyror, që lidhet me vazhdimësinë e livrimit dhe cilësinë e gazit natyror që hyn në sistemin e transmetimit dhe ruajtjen e cilësisë së tij deri në daljen nga sistemi;

b) hartimin e një metodologjie për standardet dhe monitorimin e cilësisë së gazit natyror në pikat e hyrjes dhe të daljes së sistemit të transmetimit, si pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar nga ERE;

c) monitorimin në vijimësi të cilësisë së gazit të transmetuar dhe dorëzimit pranë ERE-s të raporteve periodike, në përputhje me metodologjinë e aprovuar;

d) përcaktimin e vendndodhjeve të kontrollit të cilësisë së gazit;

e) marrjen e të gjitha masave për sigurinë e jetës së njeriut dhe parandalimin e aksidenteve të ndryshme, që mund të ndodhin gjatë transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

Neni 13

Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE, duke vepruar brenda kompetencave të saj, kryen monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e termave e kushteve të licencës përkatëse, për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, për tregun e gazit natyror në Shqipëri.



2. ERE do të monitorojë vazhdimisht shfaqjen e praktikave kufizuese kontraktuale, përfshirë klauzolat e ekskluzivitetit, të cilat mund të parandalojnë klientët e mëdhenj të kontraktojnë në të njëjtën kohë më shumë se një furnizues ose të kufizojnë zgjedhjen e tyre për ta bërë këtë dhe informon Autoritetin e Konkurrencës për praktika të tilla.

3. Të licencuarit, të cilët shkelin kushtet e përcaktuara si më sipër, do të jenë përgjegjës sipas dispozitave të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e gazit natyror në Shqipëri”.

4. Jo me vonë se data 31 mars e çdo viti, furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik harton raportin vjetor, të cilin e dërgon për miratim në ERE, për veprimtarinë e furnizimit të realizuar si detyrim i shërbimit publik për vitin paraardhës.

5. Ky raport vihet në dispozicion të Këshillit të Ministrave dhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

6. ERE informon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për të gjitha masat e vendosura për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sipas këtij vendimi, ndikimin e tyre të mundshëm në hapjen e tregut.

7. ERE njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë periodikisht, të paktën çdo dy vjet, për çdo ndryshim të kushteve për vendosjen e

detyrimeve të shërbimit publik të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky akt nënligjor hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5386, datë 11.12.2020, vendosi shpalljen si të zhdukur të shtetasit Skënder Ajazi, nga data 1.7.1997, si dhe caktimin në cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij vëllanë e tij, shtetasin Gëzim Ajazi.

KËRKESE

Shtetasja Xhemaile Çaçë kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë deklarin të vdekur të shtetasit Naxhi Nebi Çaçë, i datëlindjes 12.5.1963, lindur në Synej, Njësia Administrative Synej, Bashkia Kavajë.

KËRKUESE

Xhemaile Çaçë

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 464 lekë